

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5659
E premte, 21 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Shoqëria civile rekomandon kufizimin e numrit të ministrive

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**FREDERIKA
MOGERINI,
HASHIM THAÇI
DHE BISEKSU-
ALITETI POLITIK
I LDK-së!** F. 12



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**NARKOZA E
VIZAVE, MIT
APO REALITET
(1)** F. 11



Shkruan:
Agron HOTI

**MPB-ja U BËNË
APEL QYTETARËVE:
LEGALIZOJINI ARMËT** F. 7

EKONOMI

**LLUKA TAKON ORGANET
PËRGJEGJËSE PËR SEKTORIN
ENERGJETIK TË VENDIT** F. 8

**VETËM 11 PËR QIND E GRAVE
NË KOSOVË JANË PRONARE TË
BIZNESEVE** F. 8

KULTURË

**NËNSHKRUHEN KONTRATAT
PËR FINANCIMIN E
70 NDËRMARRËSVE TË RINJ** F. 13

SPORT

**HARADINAJ: HENDBOLLI YNË
T'I ARRIJË MAJAT
E HENDBOLLIT BOTËROR** F. 15



FLET PËR "EPOKËN E RE", ILIR IBRAHIMI | FAQE 4-5

Kosova duhet t'i përmbushë pritshtëritë e ShBA-së për procesin e dialogut

Profesori i qeverisjes amerikane, Ilir Ibrahim, i ka bërë thirrje lidhshpirt të Kosovës që ta dëgjojë porosinë e Amerikës për dialogun. Ai ka thënë se partitë politike duhet ta kuptojnë qartë letëren e presidentit Trump dhe t'i përmbushin pritshmëritë e ShBA-së për këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ibrahim ka deklaruar se marrëveshja Kosovë - Serbi do të garantohet nga ShBA-ja dhe BE-ja, prandaj nuk duhet të humbet ky shans. Ai ka theksuar se partitë duhet t'i lënë anash interesat dhe inatet personale për të ndërtuar një zë unik për dialogun siç po kërkon ShBA-ja. Ibrahim ka vlerësuar se LDK-ja si partia më e madhe opozitare dhe si partia që ka kontribuar në çdo proces nuk duhet të rrijë anash dialogut

Veseli thërret takimin e parë të përbashkët me liderët politikë dhe ekipin negociator



Me qëllim të koordinimit të veprimeve për dialogun me Serbinë, kryeparlamentari Kadri Veseli javën e ardhshme i ka ftuar në një takim liderët kryesorë të institucioneve

shtetërore, ekipin negociator dhe liderët e LDK-së dhe të LV-së. Ai ka thënë se Kuvendi duhet të jetë vendi i unitetit të partive politike, ku do të diskutohen temat e dia-

logut me Serbinë. Kurse bashkëkryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, të enjten kanë filluar takimet me krerët institucionalë | FAQE 3

Autostrada 'Arbën Xhaferi' po merr formën përfundimtare

FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO

Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Trumpi i shkruan Vuçiqit për marrëveshjen me Kosovën

BEOGRAD, 20 DHJETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, në një letër dërguar presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se marrëveshja ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është "afër dorës".

Në letër e dërguar më 14 dhjetor, të cilën të enjten e ka publikuar Zyra e presidentit të Serbisë, Trumpi ka theksuar se i gëzohet rastit që t'i presë në Shtëpinë e Bardhë presidentin e Serbisë dhe atë të Kosovës, Aleksandar Vuçiq dhe Hashim Thaçi, për ta festuar "marrëveshjen historike". "Marrë

parasysh se po hyni në fazën përmbyllëse të arritjes së marrëveshjes me Kosovën, e cila do të sjellë paqen e dëshiruar afatgjatë në rajon, ju inkurajoj që ta shfrytëzoni këtë moment dhe të përdorni liderizmin politik për sjelljen e vendimeve që do t'i kënaqnin interesat e të dy vendeve. Do të ishte dëm i madh që të lëshohet ky rast unik për paqen, sigurinë dhe rritjen e ekonomike", ka thënë Trumpi. Presidenti Trump ka theksuar se ShBA-ja është e gatshme që të ndihmojë në arritjen e marrëveshjes për normalizim

dhe ka vlerësuar që "marrëdhëniet paqësore dhe produktive ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të ishin pikë kthese për rajonin". "Marrëveshja ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është afër dorës. I gëzohem rastit që juve dhe presidentin Hashim Thaçi t'iu mirëpres në Shtëpinë e Bardhë, në mënyrë që të festojmë atë që do të paraqiste marrëveshjen historike", ka thënë Trumpi. "ShBA-ja vlerëson liderizmin e juaj, veçanërisht në sigurimin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve me Kosovën", ka thënë Trumpi.



Autostrada 'Arbën Xhaferi' po merr formën përfundimtare

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, gjatë vizitë inspektuese në punimet që janë duke u zhvilluar në përfundimin e urës 407, ka deklaruar se mbështetja e rezervë e Qeverisë së Kosovës dhe kryeministrit Haradinaj ka bërë të mundur që projekti i autoudhës "Arbën Xhaferi" të përfundojë si duhet dhe brenda afateve të dakorduara

KAÇANIK, 20 DHJETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, të enjten ka realizuar vizitë inspektuese në punimet që janë duke u zhvilluar në përfundimin e urës 407, në autostradën "Arbën Xhaferi", me ç'rast është vendosur trari i fundit në këtë urë. Ministri Lekaj, duke kërkuar nga kompania kontraktuese që punimet e mbetura të realizohen me standarde të larta, i ka përgëzuar të gjithë punonjësit që me kontributin e tyre të palodhshëm kanë bërë që ky projekt të realizohet me cilësi të lartë. "Kjo urë po lidhë Kosovën me Perëndimin dhe të gjitha shtetet që na kanë përkrahur. Sot kemi vendosur trarin e 1414 në këtë urë, që tregon se kjo urë është më e

gjata dhe më e larta në rajon si pjesë e një autoudhe që lidhë korridor me rëndësi dhe i kontribuon edhe zhvillimit ekonomik të vendit", ka thënë ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj. Ai ka deklaruar se mbështetja e rezervë e Qeverisë së Kosovës dhe kryeministrit Haradinaj ka bërë të mundur që projekti i autoudhës "Arbën Xhaferi" të përfundojë si duhet dhe brenda afateve.

Kreu i dikasterit infrastrukturor ka bërë me dije se projekti nuk do të përfundojë brenda këtij viti për shkak të kushteve atmosferike në mënyrë që ato të mos ndikojnë në cilësinë e punimeve në këtë projekt madhor për vendin dhe qytetarët.



Kurse sa i përket mbylljes së rrugës nacionale, u tha se që sot rruga do të jetë e hapur për qarkullim. Ndërsa Riyadh Alkhazraji nga "Bechtel &

Enka" e ka falënderuar ministrin Lekaj dhe ministrinë që ai e drejton, duke mos e lënë anash edhe qeverinë për përkushtimin e jashtëzakon-

shëm që t'i mënjanojnë të gjitha pengesat e shfaqura gjatë realizimit të këtij projekti me rëndësi për qytetarët e Kosovës.

Netanjahu anuloi vizitën në Tiranë për shkak të diplomatëve të Iranit

TIRANË, 20 DHJETOR - Një ditë pas vendimit për dëbimin e dy diplomatëve të Ambasadës së Iranit në Tiranë, pjesa tjetër e stafit të ambasadës vijon punën normalisht. Përveç ambasadorit, personi i dytë i shpallur "non grata" mendohet se është një bashkëpunëtor i ngushtë i tij, në funksionin e këshilltarit, por ende nuk ka një konfirmim dhe as një identitet nga autoritetet. Diplomatët e shpallur "non grata"



dyshohet se kanë lidhje me dy shtetas iraniane të dëbuar po gjatë këtij viti nga Shqipëria. Sipas burimeve, në mars të 2018-s

dy persona që pretendonin se ishin gazetarë iraniane kishin ardhur në Shqipëri për të ndjekur festën e Sulltan Novruzit. Shtetasit EZ dhe S.M. u dëbuan pasi ishin skeduar më parë nga agjencitë ligjzbatuese si individë që përbënin rrezik për komunitetin muxhahedin të strehuar në Shqipëri. Sipas burimeve, dy iraniane që hiqeshin si gazetarë dhe u dëbuan në mars të këtij viti kanë dalë në përgjimet e

Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Antiterrorit edhe pas arrestimeve që parandaluan një sulm terrorist në ndeshjen e futbollit Shqipëri-Izrael. Ndërkohë, dëbimi i diplomatëve iraniane është paralajmëruar vetëm pak ditë më parë nga një ish-kongresist amerikan në një takim me organizatën e MEK-ut në Shqipëri. Ish-kongresisti Patrick Kennedy tha se Qeveria shqiptare duhet të

nxjerrë jashtë çdo diplomat iraniane në këtë vend. Për shkak të aktivitetit të diplomatëve të dëbuar, dyshohet se është anuluar edhe vizita e kryeministrit izraelit Benjamin Netanjahu në Shqipëri, në fillim të nëntorit. Në atë kohë u tha se kryeministri e anuloi vizitën për shkak të ndarjes nga jeta të një ministri të kabinetit të tij, por po atë ditë Netanjahu u shfaq në një vend tjetër ballkanik.

Javën e ardhshme takohen liderët politikë dhe ekipi negociator për të diskutuar për dialogun

Veseli thërret takimin e parë të përbashkët me liderët politikë dhe ekipin negociator



Me qëllim të koordinimit të veprimeve për dialogun me Serbinë, kryeparlamentari Kadri Veseli javën e ardhshme i ka ftuar në një takim liderët kryesorë të institucioneve shtetërore, ekipin negociator dhe liderët e LDK-së dhe LV-së. Ai ka thënë se Kuvendi duhet të jetë vendi i unitetit të partive politike, ku do të diskutohen temat e dialogut me Serbinë. Kurse bashkëkryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, të enjten kanë filluar takimet me krerët institucionalë

temat e dialogut të cilat janë të domosdoshme për arritjen e marrëveshjes finale, që Kosovës ia siguron njohjen nga Serbia, ulësen në OKB dhe anëtarësimin në NATO dhe BE", është thënë në deklaratën e Veselit.

Ndërsa bashkëkryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, kanë filluar të enjten takimet me krerët institucionalë me qëllim të koordinimit të veprimeve dhe afateve për procesin e dialogut. Ata ndaras kanë takuar kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinj, nga të cilët kanë marrë mbështetje të plotë të këtij ekipi në procesin e dialogut. Sipas liderëve institucionalë, ky proces do të përmbyllet bashkërisht dhe në mënyrë të suksesshme. "Me bashkëkryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, për t'u koordinuar lidhur me dialogun. Kuvendi i Kosovës është në dispozicion të plotë për këtë proces të rëndësishëm për vendin, në mënyrë që bashkë-

ishtë ta përmbyllim atë me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia dhe ulësen në OKB", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook" pas takimit me Limajn dhe Ahmetin.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj në takim me udhëheqësit e ekipit negociator është zotuar se kabineti i tij do të jetë në funksion të ekipit. "Me qëllim të koordinimit të veprimeve dhe afateve për procesin e dialogut, takova sot bashkëkryesuesit e ekipit negociator të votuar në Kuvend, së bashku me grupin e ekspertëve të Zyrës së Kryeministrit. Qeveria e Kosovës ka ndërtuar një ekip dinamik të ekspertëve që ka përgatitur materien gjithëpërfshirëse, të gjallë, të hapur për debat, që procesi i dialogut ndërmjet dy shteteve të jetë transparent. U zotova se Qeveria do të jetë në funksion të plotë të ekipit negociator dhe ai mund të llogarisë tërësisht në ekspertizën të cilën e kanë të gjithë mekanizmat dhe sektorët e shtetit", ka shkruar Haradinaj

në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se këto takime janë në funksion të koordinimit të veprimeve dhe marrjes së gjithë informacioneve dhe dokumentacionit se çka është diskutuar deri me tani në bisedime me Serbinë. Limaj ka deklaruar se procesi i dialogut me Serbinë do të përshkruhet me transparencë të plotë dhe llogaridhënie. Një ditë më parë delegacioni shtetëror për bisedime me Serbinë ka mbajtur mbledhjen e parë konstituive në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se më 15 janar do t'ia dorëzojnë Kuvendit platformën për dialogun.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, një ditë më parë, në një konferencë për media, ka bërë me dije se kjo parti nuk do të jetë pjesë e ekipit negociator, por do të jetë faktor korrektues i vendimeve që merren në Kuvendin e Kosovës sa i përket dialogut me Serbinë.

EPOKA ERE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka bërë me dije se javën e ardhshme (të mërkurën) i ka ftuar për në një takim të përbashkët liderët kryesorë të institucioneve shtetërore, ekipin negociator dhe liderët e partive politike për t'i trajtuar temat e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se Kuvendi i Republikës së Kosovës do të jetë vendi i unitetit, ku do të

diskutohen temat e dialogut, të cilat janë të domosdoshme për arritjen e marrëveshjes finale. "Në këto momente të rëndësishme, kur Kosova përgatitet për fazën finale të dialogut me Serbinë, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të jetë vendi i unitetit. Si kryetar i Kuvendit do t'i ftoj për të mërkurën, në orën 10:00, presidentin, kryeministrin, ekipin negociator, si dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare nga partitë opozitare ende të papërfaqësuar në ekipin negociator, LDK-në dhe VV-në. Do të mblidhemi për t'i trajtuar

Në UP mbahet ceremonia e certifikimit të praktikantëve

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Në rektoratin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të enjten është mbajtur ceremonia e certifikimit të praktikantëve, të cilët kanë përfunduar me sukses programin e punës praktike në administratën e UP-së, si dhe grupit të studentëve vull-

netarë. Rektori i UP-së, Marjan Dema, i ka përgëzuar studentët e pranishëm për punën dhe ka theksuar rëndësinë e punës vullnetare të cilën ai e ka konsideruar vlerë të jashtëzakonshme për individin. Në këtë ceremoni morën pjesë 61

praktikantë, të cilët e kryen praktikën profesionale në periudhën korrik-shtator 2018, 81 praktikantë të cilët e përfunduan praktikën profesionale në periudhën tetor-dhjetor 2018, si dhe 13 vullnetarë të cilët shërbyen gjatë periudhës tetor-dhjetor në aktivitetet e organizuara nga UP-ja.



Flet për "Epokën e re", Ilir Ibrahimimi

Kosova duhet t'i përmbushë pritshmëri



Profesori i qeverisjes amerikane, Ilir Ibrahimimi, i ka bërë thirrje lidershit të Kosovës që ta dëgjojë porosinë e Amerikës për dialogun. Ai ka thënë se partitë politike duhet ta kuptojnë qartë letrën e presidentit Trump dhe t'i përmbushin pritshmëritë e ShBA-së për këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ibrahimimi ka deklaruar se marrëveshja Kosovë - Serbi do të garantohet nga ShBA-ja dhe BE-ja, prandaj nuk duhet të humbet ky shans. Ai ka theksuar se partitë duhet t'i lënë anash interesat dhe inatet personale për të ndërtuar një zë unik për dialogun siç po kërkon ShBA-ja. Ibrahimimi ka vlerësuar se LDK-ja si partia më e madhe opozitare dhe si partia që ka kontribuar në çdo proces nuk duhet të rrijë anash dialogut

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Profesori i qeverisjes amerikane, Ilir Ibrahimimi, ka thënë të enjten se letra e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, dërguar presidentit Hashim Thaçi, përveçse e rikonfirmon përkrahjen amerikane ndaj Kosovës, dërgon edhe mesazhe të qarta për liderшипin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se procesi i dialogut me Serbinë duhet të përmbyllet me një marrëveshje e cila do të garantohet nga ShBA-ja dhe

BE-ja prandaj, sipas Ibrahimimit, nuk duhet të humbet ky shans. "Nuk ndodh shpesh që lideri i botës së lirë, siç quhet ndryshe presidenti amerikan, t'i shkruajë një letër kaq të qartë një homologu, me pritshmëri të qarta si në përmbajtje, ashtu edhe në kohë. Ky mendoj është edhe një kontribut i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën dhe rajonin drejt lëvizjes nga ky status që nuk ka mundur të tejkalohet deri tani pa një ndërhyrje amerikane", është shprehur ai, duke shtuar se partitë politike e kanë kuptuar qartë këtë letër për t'i përmbushur pritshmëritë që ka ShBA-ja nga procesi i dialogut. "Një

nga kërkesat e kësaj letre është ndërtimi i një zëri unik dhe për të arritur atë të gjitha partitë politike duhet t'i lënë anash interesat dhe inatet personale dhe të ndërtojnë atë zë unik", ka deklaruar Ibrahimimi. Sipas tij, LDK-ja si partia më e madhe opozitare dhe si partia e cila ka kontribuar në çdo proces nuk duhet të rrijë anash. Ibrahimimi ka theksuar se kjo nuk është e shëndoshë as për LDK-në e as për procesin. "Pra, në ditët në vijim besoj dhe inkurajoj që spektri politik, përfshirë LDK-në, të ulet dhe ta trajtojë këtë realitet të ri me gjakftohtësi, duke vënë interesin e vendit mbi çdo interes partiak", ka thënë ai.

të e ShBA-së për procesin e dialogut

arsye të interesave individuale të vihet në pikëpyetje e ardhmja e vendit", ka thënë Ibrahim.

"Epoka e re": Z. Ibrahim, letra e presidentit amerikan Donald Trump dërguar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka nxjerr reagime të shumta në skenën politike. Si e keni parë dhe kuptuar këtë letër?

Ibrahimi: Letra e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, përveç që e rikonfirmon përkrahjen amerikane për Kosovën, dërgon edhe disa mesazhe të qarta se çfarë pritet nga lidhshipi i Kosovës. Procesi i dialogut me Serbinë duhet të përmbyllet me një marrëveshje e cila do të garantohet nga ShBA dhe BE-ja, si dhe duhet të mos humbet ky shans. Nuk ndodh shpesh që lideri i botës së lirë, siç quhet ndryshe presidenti amerikan, t'i shkruajë një letër kaq të qartë një homologu, me pritshmëri të qarta si në përmbyllje, po ashtu edhe në kohë. Ky mendohet është edhe një kontribut i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën dhe rajonin, drejt lëvizjes nga ky status që nuk ka mundur të tejkalohet deri tani pa një ndërhyrje amerikane.

"Epoka e re": Janë duke e kuptuar drejt porosinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës partitë politike dhe drejtuesit e tyre?

Ibrahimi: Besoj se partitë politike e kanë kuptuar qartë këtë letër dhe po shpresoj se do t'i marrin hapat adekuatë për t'i përbushur pritshmëritë që ka ShBA-ja nga procesi i dialogut. Një nga kërkesat e kësaj letre është ndërtimi i një zëri unik dhe për ta arritur atë, të gjitha partitë politike duhet t'i lënë anash interesat dhe inatet personale dhe të ndërtojnë atë zëri unik.

"Epoka e re": Sidoqoftë, as kjo letër dhe as garancia amerikane për procesin e dialogut nuk ka arritur t'i bindë Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjen Vetëvendosje që të përkrahin këtë proces dhe të bëhen pjesë e ekipit negociator. Si e komentoni këtë dhe a prisni reflektim, të paktën nga LDK-ja?

Ibrahimi: Të mërkurën e kemi parë reagimin e parë të Lidhjes Demokratike të Kosovës pas kësaj letre, por nuk mendoj se LDK-ja, si partia më e madhe opozitare dhe si partia e cila ka kontribuar në çdo proces, të rrijë anash. Kjo nuk është e shëndoshë as për LDK-në e as për procesin. Pra, në ditët në vijim besoj dhe inkurajoj që spektri politik, përfshirë LDK-në, të ulet dhe ta trajtojë këtë realitet të ri me

gjakftohësi, duke vënë interesin e vendit mbi çdo interes partiak. Gjithsecili duhet ta luajë rolin e vet në këtë proces bazuar në legjitimitetin politik, sepse e kanë edhe obligim që atë legjitimitet të marrë nga votuesi ta çojnë përpara duke ruajtur më së miri interesat e qytetarëve.

"Epoka e re": Z. Ibrahim, pas porosisë amerikane dhe funksionalizimit të ekipit negociator, si e shihni vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi?

Ibrahimi: Duke lexuar letrën e presidentit Trump, por edhe duke parë zhvillimet në muajt e fundit, mendoj se konturat

themelore të një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë tanimë janë vendosur. Por, ne kemi aq shumë çështje të hapura me Serbinë, prandaj ekipi negociator duhet të plotësohet sa më shpejt dhe të përfshijë sa më shumë ekspertë nga fusha të ndryshme për të trajtuar dhe negociuar ato çështje. Përdorimi i ekipit do të udhëhiqet nga presidenti, do të ketë vend dhe mundësi për të kontribuar në këtë ekip për të gjithë. Shpresoj se klasa politike e ka kuptuar mesazhin dhe do të arrijë të krijojë një ekip i cili do të flasë me një zë. Kështu edhe

do të arrijmë një marrëveshje më të mirë për Kosovën.

"Epoka e re": Prisni që marrëveshja finale Kosovë - Serbi të arrihet në një të ardhme të afërt siç po thuhet dhe cili besoni se do të jetë kompromisi i saj?

Ibrahimi: Nga ajo që kemi mundur të shohim, marrëveshja është çështje muajsh, prandaj është imperative që Kosova dhe ekipi negociator ta fillojnë punën menjëherë. Tanimë kemi humbur shumë kohë dhe nuk mund t'ia lejojmë vetes që për arsye të interesave individuale të vihet në pikëpyetje e ardhmja e vendit.

Shoqëria civile rekomandon kufizimin e numrit të ministrive

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Ka filluar procesi i konsultimit me përfaqësues të shoqërisë civile nga organizatat Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Democracy Plus dhe D4D, për Projektligjin për Qeverinë në diskurs të gjerë publik. Për këtë proces, koordinatori për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka pritur të enjten në takim përfaqësues të shoqërisë civile. "Në mënyrë shumë të hapur u reflektua mbi çështjet se në çfarë baza duhet të zhvillohet plani i ristrukturimit të Qeverisë, cilat janë rekomandimet e shoqërisë civile dhe a duhet rezultuar kjo me përcaktimin e një numri maksimum të dikastereve apo t'i lihet mundësi e hapur për mandatarin të përcaktojë se me çfarë numri të dikastereve/ministrive do ta zbatojë programin e tij politik", ka treguar pas takimit Tahiri. Ai ka thënë se në këtë

takim është diskutuar mbi atë nëse ka kufizime kushtetuese për këtë ligj dhe cila do të jetë vlera e shtuar e këtij ligji, si dhe me çfarë numri të votimit duhet të votohet ky ligj në mënyrë që mos të pësojë ndryshime të njëpasnjëshme nga qeveritë e ardhshme. Tahiri ka thënë se shoqëria civile ka rekomanduar kufizimin e numrit të ministrive. "Nga ana e shoqërisë civile u konfirmua nevoja se përderisa jemi në një periudhë të reformës së administratës publike, përkundër fragmentimeve politike, për një funksionim të mirë shtetëror duhet kufizuar numri i ministrive dhe kjo duhet të bëhet përmes vendosjes së dikastereve dhe ministrive pa portofol, duke vendosur cakun e lartë mbi këtë numër, përfshirë edhe numrin e këshilltarëve. Kjo do të jetë në harmoni dhe konsistencë me synimin e Qeverisë për

reformën e administratës publike me pakon e tre ligjeve duke përfshirë Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Ligjin për Shërbyesit Publikë dhe Ligjin për Pagat", është shprehur Tahiri. Sipas Tahirit, në vazhdim pritet që ky diskutim me shoqërinë civile të zgjerohet edhe më tej me organizata të tjera dhe si proces të sigurojë një përfshirje të profesionistëve vendorë, por edhe ekspertëve nga BE-ja. "Qeveria është e angazhuar t'i përshpejtojë procedurat për miratimin e Projektligjit për Qeverinë për ta rregulluar strukturën qeveritare dhe fushat e përgjegjësive brenda Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si mjet për sigurim të qeverisjes efektive, efikase dhe transparente ndaj qytetarëve të saj", ka theksuar Tahiri.



Ibrahimi ka thënë se, duke pasur parasysh letrën e presidentit Trump dhe zhvillimet e fundit, konturat themelore të marrëveshjes Kosovë - Serbi tanimë janë vendosur. "Shpresoj se klasa politike e ka kuptuar mesazhin dhe do të arrijë të krijojë një ekip i cili do të flasë me një zë. Kështu edhe do të arrijmë një marrëveshje më të mirë për Kosovën", ka potencuar Ibrahim, duke shtuar se arritja e kësaj marrëveshjeje është çështje muajsh. "Prandaj është imperative që Kosova dhe ekipi negociator ta fillojnë punën menjëherë. Tanimë kemi humbur shumë kohë dhe nuk mund t'ia lejojmë vetes që për

MSh-ja lansoi edhe tre udhërrëfyes klinikë për menaxhimin e sëmundjeve jongjitëse

Udhërrëfyesit e lansuar të enjten nga Ministria e Shëndetësisë (MSh), në bashkëpunim me SDC, janë: Udhërrëfyesi për menaxhimin e hipertensionit arterial; Udhërrëfyesi për menaxhimin e astmës bronkiale dhe Udhërrëfyesi për menaxhimin jofarmakologjik të sëmundjes së sheqerit

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Në kuadër të procesit për zhvillimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike, Ministria e Shëndetësisë, me përkrahjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë, ka lansuar të enjten tre udhërrëfyes të tjerë klinikë për kujdesin parësor shëndetësor: Udhërrëfyesin për menaxhimin e hipertensionit arterial;

Udhërrëfyesin për menaxhimin e astmës bronkiale dhe Udhërrëfyesin për menaxhimin jofarmakologjik të sëmundjes së diabetit.

Në emër të ministrit Uran Ismaili dhe Ministrisë së Shëndetësisë, sekretari i përgjithshëm, dr. Naim Bardiçi ka falënderuar SDC-në që përmes projektit të AQH-së-së, për ofrim të shërbimeve të qasshme dhe cilësore në sektorin e shëndetësisë, ka ofruar përkrahjen e tyre edhe për publikimin e këtyre tre

udhërrëfyesve për KPSH, sikurse edhe Qeverinë e Luksemburgut dhe UNFPA-në për mbështetjen e tyre për procesin e zhvillimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike për nivelet e tjera të kujdesit shëndetësor në Kosovë. "Nevoja për udhërrëfyes dhe protokolle klinike është një nga çështjet kryesore në sektorin e shëndetësisë. Përmes procesit të përcaktuar me kriteret qartë të definuara, është bërë prioritetizimi i fushave për hartim të këtyre dokumenteve, me theks të veçantë në përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe shëndetit riprodhues dhe kujdes parësor shëndetësor. Në këtë kontekst është bërë edhe adaptimi i udhërrëfyesve klinikë të cilët, pas hartimit nga ana e grupeve të profesionistëve

shëndetësorë dhe pas procedimit nëpër të gjitha fazat e përcaktuara, janë aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë", ka thënë Bardiçi, duke shtuar se ky është vetëm hapi i parë në këtë proces i cili duhet të vazhdohet intensivisht me zbatim të tyre në praktikën e përditshme të profesionistëve shëndetësorë. "Kërkoj nga të gjithë profesionistët shëndetësorë, tek të cilët gjejnë zbatueshmëri këto dokumente, të ofrojnë shërbime shëndetësore bazuar në udhërrëfyes dhe t'i shfrytëzojnë ato në punën e tyre të përditshme", ka thënë ai. Zëvendësudrejtori i SDC-së për Kosovë, Bernhard Soland, ka thënë se sëmundjet jongjitëse si hipertensioni dhe diabeti janë një problem global që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën

e të prekurve dhe familjeve të tyre. Ai ka theksuar se projekti AQH ka zhvilluar pakon e shërbimeve për diabet dhe hipertension që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor. Ai ka thënë se SDS-ja përmes AQH-së ka mbështetur Këshillin Nacional për Udhërrëfyes dhe Protokolle në tre aspekte: Në ofrimin e ekspertizës për hartimin dhe implementimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve; në ofrimin e materialeve referente për udhërrëfyes e protokolle dhe në ofrimin e asistencës teknike përmes logjistikës në përfundimin dhe publikimin e tre udhërrëfyesve të lansuar, të cilët do të ndihmojnë edhe në referimin e sëmundjeve jongjitëse brenda sistemit shëndetësor në Kosovë.



FSK-ja mban ligjëratë për vetëdijesimin nga rreziku i mjeteve piroteknike

Prishtinë, 20 dhjetor (ER) - Tashmë që po afrohen festat e fundvitit, përdorimi i mjeteve piroteknike nga ana e të rinjve në Kosovë është rritur shumë. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe drejtoritë komunale të arsimit nëpër komuna, kanë organizuar fushatë vetëdijesimi nëpër shkollat fillore të Kosovës me qëllim të ndërgjegjësimit të nxënësve për rrezikun që mund të shkaktojë përdorimi nga ana e tyre i mjeteve piroteknike.



Fushata është realizuar nga data 10 deri më 19 dhjetor dhe janë përfshirë nxënës të shkollave fillore të Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Ferizajt, Gjilanit dhe Dragashit. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 17 orë mësimi ku kanë marrë pjesë mbi 1 000 nxënës. Ligjëratat janë mbajtur nga instruktorët e Kompanisë së Çminimit, të cilët janë të përgatitur dhe të trajnuar për mjete të rrezikshme. Nxënësit shfaqen interesim të madh gjatë këtyre ligjëratave, që

u pa edhe nga pyetjet e tyre të shumta rreth këtyre mjeteve. Vlen të ceket se një numër i madh i tyre ishin mjaft të zëshëm kundër përdorimit të tyre. Instruktorët ligjërues të angazhuar në këtë aktivitet, rreshter Valon Abdyli, tetar Butrint Kastrati, tetar Liridona Musaj, tetar Shpejtim Gashi, shprehen mjaft të kënaqur me interesimin e nxënësve dhe angazhimin e personelit të shkollave ku janë realizuar këto ligjëratë.

KDI-ja rekomandon pesë standarde për ngritjen e transparencës së subjekteve politike

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar një analizë ligjore lidhur me partitë politike dhe transparencën në fushatë e cila përmban pesë standarde që kanë të bëjnë me publikimin e emrave të të gjithë anëtarëve të shtabit zgjedhor, detyrimin ligjor që i obligon partitë për hapjen e llogarive financiare, publikimin e financave të secilit kandidat në fushatë, publikimin e të dhënave edhe për subjektet juridike (kompanitë) që japin donacione për subjektin politik dhe publikimin e kalendarëve të të gjitha ngjarjeve gjatë fushatës

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të enjten ka mbajtur tryezë diskutimi gjatë së cilës është prezantuar një analizë ligjore lidhur me partitë politike dhe transparencën në fushatë, e cila përmban pesë standarde me të cilat kërkohet ngritja e transparencës dhe e llogaridhënies së subjekteve politike para publikut.

Në hapje të kësaj tryeze, pjesë e së cilës ishin deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile, drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka bërë me dije se kjo analizë ka për qëllim ngritjen e transparencës së partive politike dhe vjen si shkëmbim i përvojave me Transparency International të Republikës së Çekisë.

Kurse Florent Spahija nga KDI-ja ka folur për të gjeturat dhe reko-

mandimet e kësaj analize duke shpjeguar standardet të cilat rekomandohen për subjektet politike me qëllim të ngritjes së llogaridhënies përtej detyrimeve ligjore. Këto standarde kanë të bëjnë me publikimin e emrave të të gjithë anëtarëve të shtabit zgjedhor, detyrimin ligjor që i obligon subjektet politike për hapjen e llogarive financiare, publikimin e financave të secilit kandidat në fushatë, publikimin e të dhënave edhe për subjektet juridike (kompanitë) që japin donacione për subjektin politik dhe jo vetëm pronarëve, publikimin e kalendarëve të të gjitha ngjarjeve të cilat do t'i realizojë subjekti politik gjatë fushatës. "Pra, duhet të ketë publikim të emrave të të gjithë anëtarëve të shtabit zgjedhor të subjektit politik si dhe të bëhet caktimi dhe publikimi i emrit të menaxherit financiar për fushatën. Publikimi i emrave të anëtarëve të shtabit zgjedhor (dhe shtabeve në degë regjionale) të



subjektit politik dhe emrit të financiarit të emëruar vetëm për fushatë do ta rriste transparencën e subjektit politik përballë publikut", ka thënë Spahija.

Duke folur për standardin e radhës që duhet të arrihet, detyrimin ligjor që i obligon subjektet politike për hapjen e llogarive financiare për shpenzimet e fushatës zgjedhore ka shtuar se hapja e llogarive nënkupton bërjen publike e të qasshme në kohë reale përmes portalit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndonjë portali tjetër

apo vetë portalit të subjektit politik/kandidatit. "Po ashtu, duhet të bëhet publikimi i financave të secilit kandidat në fushatë. Secili subjekt politik duhet t'i publikojë dhe duhet t'i detyrojë të gjithë kandidatët që të raportojnë në subjektin me të cilin kandidojnë. Të dihet cili është kontributi financiar i tyre në fushatën e subjektit politik, me të dhënat se nga e ka financuar kandidati fushatën e tij personale", ka shpjeguar ai. Publikimi i të dhënave, sipas Spahisë, duhet të bëhet edhe për subjektet juridike (kompanitë) që japin donacione për subjektin

politik dhe jo vetëm pronarëve dhe se me këtë ndryshim ligjor publiku do ta kuptonte se cili është pronari i fundit që ka dhënë donacionin për subjektin politik, sidomos te kompanitë që kanë shumë pronarë, të cilët mbahen të fshehur. "Duhet të bëhet edhe publikimi i kalendarëve të të gjitha ngjarjeve të cilat do t'i realizojë subjekti politik gjatë fushatës. Këtu duhet të përfshihen edhe ngjarjet të cilat janë organizuar apo do të organizohen nga kandidatët pa përkrahjen e subjektit politik", ka thënë Spahija.

MPB-ja u bënë apel qytetarëve: Legalizojini armët

EPOKA ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur konferenca për media për procesin e legalizimit në përputhje me Ligjin nr. 05/l-134 si dhe është dhënë njoftimi lidhur me fushatën për legalizim të armëve. Koordinator i Nacional i Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla të Lehta dhe të Eksplozivëve, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka bërë apel të të gjithë qytetarët që t'i legalizojnë armët, sepse ky proces është me rëndësi për Kosovën dhe një prej prioritetëve të MPB për adresimin e saj për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta.

Zëvendësministri Zeka vuri në dukje se Kosova ka bërë progres në kontrollin e armëve, mirëpo

ende mbetet sfidë. Ai ka thënë se përdorimi i armëve të vogla dhe të lehta paraqet kërcënim për qytetarët dhe jetën e tyre. Ndërsa drejtori i Departamentit për Hetime në Policinë e Kosovës, kolonel Riza Shillova, ka theksuar se posedimi i armëve ka shkaktuar numër të madh të veprave penale, ndërsa procesi për dorëzimin dhe legalizimin e tyre ndikon në uljen e vrasjeve. Ai ka treguar se janë konfiskuar armë edhe pse ky trend kohët e fundit ka rënë. Sipas tij, në vitin 2017 janë 1 200 armë të konfiskuara, kurse në vitin 2018 janë 1 171 armë. Shillova ka thënë se këto shifra tregojnë se ka sasi të madhe të armëve që i posedojnë qytetarët.

Ndërkaq Alessandra Roccasalvo, ushtruese e detyrës e përfaqësueses së përhershme UNDP në Kosovë, ka thënë se posedimi i armëve të vogla në



tërë botën dhe region po e vë në rrezik sigurinë publike, zhvillimin ekonomik dhe po merr jetë. Ajo ka deklaruar se Kosova është vend i sigurt, me

një shoqëri të sigurt dhe se mund të jetë model dhe pikë referente për rajonin. Fushata për legalizim të armëve mbështetet nga

misioni i UNDP-së në Kosovë në partneritet me Qeverinë gjermane (Zyrën për Punë të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë)

Tri shkolla në Skenderaj përfitojnë donacion nga Kryesia e Këshillit Turk në Kosovë

SKENDERAJ, 20 DHJETOR (ER) - Në kuadër të bashkëpunimit të mirë me Ambasadën e Turqisë në Kosovë dhe KFOR-it turk që shërben në vendin tonë, Kryesia e Këshillit Turk në Kosovë ka dhuruar një donacion për tri shkolla tona fillore: "Shaban Jashari", "Ahmet Delia" dhe "Drenica", si llap-top, kino-projektor, perde për kino-projektor, banka dhe karrige shkollore dhe vitrina, për nevojat e shkollës. "Në emër të

Komunës së Skenderajt dhe qytetarëve e falënderova kolonelin Cem Sinan Barim, komandant i Kryesisë së Këshillit Turk për këtë donacion. Komuna e Skenderajt do të jetë e hapur për bashkëpunim me të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e shteteve mike të Kosovës, në të mirë të nxënësve dhe qytetarëve tanë", ka shkruar kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari.



Bahtiri bën thirrje publike për iniciimin e peticionit për bashkimin e Mitrovicës

MITROVICË, 20 DHJETOR (ER) - Kuvendi Komunal i Mitrovicës më 30. 11. 2018 ka miratuar konkluzionin me të cilin i është propozuar Qeverisë së Kosovës iniciimi i procedurës për ndryshim të Ligjit nr./ L-041 për kufijtë administrativë të komunave, me qëllim të bashkimit të Mitrovicës, ku me

këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka lejuar që konkluzioni i miratuar të delegohet tek institucionet qendrore duke e konsideruar si jo legjitime. Nëpërmjet një deklarate për media, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, u ka bërë thirrje të

gjithë qytetarëve të Mitrovicës, personaliteteve të shquara dhe medieve, të marrin pjesë në një tryezë të përbashkët më 21. 12. 2018 në orën 10:00 në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica", me ç'rast do të iniciohen procedurat e peticionit për bashkimin e qytetit të Mitrovicës.



Begaj prezanton projektet e realizuara në takimin e dytë publik me qytetarët

MALISHEVË, 20 DHJETOR - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e dytë publik me qytetarë për këtë vit. Në këtë takim Begaj ka prezantuar para qytetarëve punën njëvjeçare të qeverisë komunale në Malishevë. Ai i ka paraqitur investimet e bëra, duke filluar me investimet në bujqësi, me dhënie të 39 serrave, 74 makinave mjelëse, 165 motokultiva-

torëve, përkrahjen me mjete konkretizuese për 153 bletarë, pastaj 80 makina për shpërndarjen e plehut kimik, 20 makina për mbjelljen e misrit dhe furnizim me lopë qumështore për 80 fermerë. Ai ka bërë me dije se shumë shpejt do të furnizohen me makina spërkatëse 350 fermerë, 40 të tjerë do të furnizohen me makina për mbjelljen e grurit dhe 40 të tjerë me makina spërkatëse

400 litra, si dhe ka njoftuar se 10 fermerëve do t'u ndërtohen stalla. Begaj ka prezantuar edhe investimet në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Ndërsa sa iu përket investimeve në infrastrukturë, ai ka thënë se këtë vit deri më tani janë ndërtuar 30 390 kilometra sistem i kanalizimeve nëpër vendbanime, 19 810 kilometra rrugë të asfaltuara dhe 14 650 kilometra trotuare.

Sigurohet uji i ngrohtë për Handikosin

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, dhe drejtoresha e Mirëqenies Sociale, Valbona Osmani, kanë marrë pjesë në përfundimin e gjashtë kolektorëve diellorë të vendosur në çatinë e objektit të

Handikosit. Përmes këtyre kolektorëve do të sigurohet uji i ngrohtë për këtë objekt, me kapacitet të rezervuarit deri në 1 000 litra. Ky projekt është financuar nga Komuna e Prishtinës dhe nga "CIMIC Autcon" e Republikës së Austrisë.



Ndalohehen pesë persona për fajde

Prishtinë, 20 dhjetor - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se, sipas kërkesës së kësaj prokurorie, me urdhër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, të enjten

janë kontrolluar 11 lokacione të ndryshme lidhur me hetimin që është duke e zhvilluar Prokuroria Speciale për veprat penale "fajdeja" nga neni 343 i KPRK-së, "detyrimi" nga neni 340 i KPRK-së

dhe "pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar" nga neni 283 i KPRK-së. Prokuroria Speciale njofton se deri më tani janë të ndaluar pesë persona, ndërsa dy të

tjerë gjenden ende në arrati, për të cilët Policia është duke e trajtuar rastin. Pasi të merret raporti informues me këtë urdhër kontrolli, policia do të veprojë në bazë të procedurave të tjera sipas KPP-së.



Vetëm 11 për qind e grave në Kosovë janë pronare të bizneseve

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Pjesëmarrja e grave në tregun e punës vazhdon të mbetet në nivele shumë të ulëta, ndërsa promovimi i tyre në ndërmarrësi është i nevojshëm në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik në vend, e për këtë është e nevojshme mbështetja e institucioneve, bizneseve dhe grave të suksesshme. Kështu u tha të enjten në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë në bashkëpunim me 'Fondacionin Jahjaga', ku u diskutua mbi rolin e gruas në ndërmarrësi dhe zhvillimi i saj. Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka deklaruar se emancipimi dhe fuqizimi i gruas në shoqërinë tonë është i domosdoshëm në zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin e vendit. Ajo ka thënë se, pavarësisht prej sfidave të shumta të

cilat gratë i hasin në ndërmarrësi, është shënuar njaft progres në këtë drejtim, falë guximit dhe iniciativave që i kanë ndërmarrë në zhvillimin e tyre profesional dhe shoqëror.

Jahjaga ka shtuar se vetëm përmes fuqizimit ekonomik, politik dhe shoqëror të gruas do të arrihet një bazë e qëndrueshme e vendit, duke thënë se kjo pastaj reflektohet në demokraci të vazhdueshme, rritje të qëndrueshme ekonomike, si dhe stabilitet në zhvillimin e sektorit privat.

Kurse shëfja e Misionit të USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, ka përmendur si dekurajuese shifrën e ulët të pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore të Kosovës, ku vetëm 20 për qind janë pjesë e tregut të punës dhe vetëm 11 për qind janë pronare të bizneseve. Ajo ka njoftuar të pranishmit se USAID-i ka punuar në këtë drejtim për zhvillimin e mundësive të reja për grate në biznes, për



promovimin dhe ofrimin e shkathtësive, duke thyer kështu barrierat për përfshirje më të madhe të grave në ndërmarrësi. Magno ka inkurajuar të pranishmet të vazhdojnë edhe më tej fuqizimin e njëra-tjetrës

duke shtuar se bizneset e tyre shërbejnë si model për vajzat e reja.

Më tutje, përfaqësueset e bizneseve anëtare të Odës Amerikane shkëmbyen stori të tyre të suksesit si dhe sfidat me të cilat

janë ballafaquar në rugëtimin e tyre, duke u zotuar se bashkërisht do të gjejnë mënyra për mbështetjen e grave dhe vajzave për një rol më aktiv të tyre në ndërmarrësi si dhe në pozita vendimmarrëse.

MTI-ja shpalli topndërmarrjet e vitit



PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, gjegjë-

sisht Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në

Kosovë (KIESA), ka shpallur të enjten topndërmarrjet e vitit

2018. Mirënjohjet u ndanë nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në bazë të regjioneve të Kosovës. Ministri Shala ka thënë se një gjë e tillë organizohet çdo vit, me qëllim që sadopak bizneseve t'u jepet përkrahje dhe moral për punën dhe angazhimin e tyre që bëjnë në vendin tonë. "Kjo është vetëm një simbolikë krahasuar me atë që meritoni si komunitet i biznesit. Shpërndarja e këtyre mirënjohjeve është kontribut i asaj që ju keni dhënë në mirëqenien tonë, punësim, teknologji, inovacione dhe përgjegjësisë ndaj shoqërisë", ka deklaruar Shala. Ministri ka treguar se në kuadër të MTI-së përmes njësisë së saj,

Agjencisë KIESA zhvillohen edhe disa projekte të tjera që përkrahin fuqizimin e prodhimit vendor. Shala ka përmendur veprimtaritë që do të përkrahin nga MTI-KIESA: Subvencionimit të makinerive prodhuese, skemat për certifikim të produkteve, përmes së cilave produktet e juaja do të certifikohen dhe të pranohen ndërkombëtarisht, gjatë vitit 2019 kjo do të përkrahët nga projekti i Bankës Botërore, skemat për këshillim, po ashtu edhe kjo gjatë vitit 2019 kjo do të përkrahët nga projekti i Bankës Botërore. Ministri Shala i ka inkurajuar bizneset që t'i përcjellin aktivitetet e MTI-së dhe të aplikojnë për të qenë pjesë e tyre.

Lluka takon organet përgjegjëse për sektorin energjetik të vendit

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka mbajtur të enjten takim me organet përgjegjëse për sektorin e energjisë në vendin tonë, gjegjësisht Korporatën Energjetike të Kosovës, KEDS, Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe KOSTT, ku ka kërkuar raportim rreth situatës energjetike në vend.

Në këtë takim u diskutuan masat të cilat duhet të merren për t'u parandaluar ndërprerjet e paplanifikuara si dhe u kërku

mobilizim që të kalohet sezoni dimëror pa probleme të mëdha. Lluka u interesua të kuptojë nga KEDS-i dhe KOSTT-i zgjidhjen e disa shqetësimeve të cilat ai i ka marrë nga banorët e Fushë-Kosovës, Suharekës dhe Prishtinës për ndërprerje të energjisë elektrike. Konstatimi i përgjithshëm ishte që situata energjetike është stabile në gjithë vendin dhe se ndërprerjet e vetme që mund të ndodhin janë për shkak të mbingarkesave në zona të caktuara në Kosovë.



Frederika Mogerini, Hashim Thaçi dhe biseksualiteti politik i LDK-së!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Letra e Trampit dhe kultura e leximit: Presidenti Tramp i nisi dy letra në të njëjtën kohë; në adresë të Hashim Thaçit, president i Kosovës dhe në adresë të Aleksandar Vuçiqit, president i Serbisë. Siç po e shihni, lexues të nderuar, është treshja e presidentëve, njëri shkruan, të tjerët lexojnë! E nisi edhe një letër në Shqipëri, jo presidentit Ilir Meta, por kryeministrit Edi Rama. Kjo letër ngjalli reagim, kryesisht pozitiv dhe nënshtrues, ende pa e lexuar, te shumica e subjekteve politike kosovare, si shenjë e miqësisë së përjetshme midis Kosovës dhe Amerikës! Thënë të drejtën, nëse kam guxim ta them, letra kishte dy argumente bindëse që e rritë lexueshmërinë dhe domosdoshmërinë e besimit, pa pasur nevojë ta lexoni fare; logoja e presidentit amerikan me shqiptonjen në të dhe nënshkrimin e presidentit Tramp, në fund të letrës, e theksuar, si nga trashësia e shkronjave ashtu edhe nga ngjyra, e zezë, shumë e theksuar e që ishin argumente të mjaftueshme për ta kuptuar tekstin e letrës, pa pasur nevojë ta lexoni fare. Dhe, pse duhet ta lexoni përmbajtjen kur i keni këto dy argumente që mund të kundërshtohen vetëm nga një budalla, si puna ime! Budallenjtë realë dhe origjinalë janë pakicë absolute, minoritet që nuk trajtohen sipas parimit të diskriminimit pozitiv, kurse budallenjtë funksionalë janë shumicë absolute të cilët i gëzojnë të gjitha përfitimet e mundshme. E

pranoj se jam në grupin e parë dhe se jam i privuar nga të gjitha të drejtat! Nënshkrimi i presidentit Tramp rrezaton me intelektualizëm dhe zgjuarsia andaj nuk mund të refuzohet. Krahasoni nënshkrimin e presidentit Tramp me nënshkrimin e presidentit Thaçi! Nuk krahasohen! I vetmi politikan që për nga intelijenca dhe zgjuarsia si dhe eleganca intelektuale e nënshkrimit e që mund të matet me presidentin Tramp në Kosovë, është Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër i Parë i Qeverisë së Kosovës dhe ministër për Punë të Jashtme, ndonëse nuk jam shumë i sigurt por, më duket se kam lexuar dhe dëgjuar se është i Kosovës. I pari që e lavdëroi fort letrën e presidentit Tramp është një president, zotëri Hashim Thaçi që po e mban në kuletë, në vend të kartës së identifikimit. Thonë se kur shkoi në Bruksel, në takim me Frederika Mogerinin, në hyrje, në vend të kartës të akreditimit, sigurimit ia tregoi letrën e presidentit Tramp duke i thënë: "Aj jam president Thaçi, likes verij gud president Tramp, infakt, shi is maj frendi, bijkoz aj jam president tu...". Pasi i krahasuan letrat e dërguara nga presidenti Tramp, Aca dhe Hasha iu gjuajtën pites që e kishte gatuar Popadija Millojka për shkak të festës së Shën Nikollës dhe marrëveshjes për korrigjim të kufijve që qenka afër nënshkrimit, si veja e pulës, buzë daljes emergjente! Edhe Kadria, kryetar i Kuvendit, më duket se ka identitetet fetar të myslimanit, pa e lexuar fare letrën e presidentit Tramp e cilësoi si bekim e që këtë cilësim kryesisht e përdorë Papa Françesku dhe të gjithë liderët dhe liderucët kosovarë, që nga përfundimi i luftës! Shumica e ndajnë mendimin me vlerësimet për letrën e presidentit Tramp e dy të fortëve të Kosovës, të tjerët, pak më të fortë dhe ata të rënë fare e që e përbëjnë shumicën absolute, kurse unë botërisht i deklaruar se i përkasë pakicës së budallenjve realë dhe origjinalë, nuk mendoj se kjo letër është aq e mirë për Kosovën dhe, e pranoj botërisht, nuk jam budalla aq i madh e të them se kjo letër është sikur: "Kërcënimi i Kërsëndellave i Bushit Plak.." ndonëse edhe kjo letër është shkruar në prag të Kërsëndellave. Pra, këto dy letra, që të dyja bartin kërcënime, ajo e Bushit Plak i drejtohej vetëm Serbisë, kurse kjo e presidentit Tramp edhe Kosovës, edhe Serbisë. Pra, këto dy letra i

bënë të njëjta vetëm koha kur janë dërguar, kurse përmbajtja është diametralisht e kundërt! Hashim Thaçi, i guximshëm siç është gjithmonë, tha publikisht: "Jemi shumë të vegjël ta kundërshtojmë letrën e presidentit Tramp...!" Unë jam edhe më i vogël, plesht fare andaj nuk pajtohem me letrën e presidentit Tramp dhe e them se nuk është aq e mirë për Kosovën dhe shqiptarët meqë nuk e përjashton zgjidhjen e uqurit të kufijve! Për mua do të ishte shumë i pranueshëm formulimi: "SHBA-ja e ka pranuar pavarësinë e Kosovës dhe Serbisë brenda kufijve ekzistues dhe vetëm brenda këtyre kufijve kërkon zgjidhje duke e përjashtuar çdo mundësi të ndryshimit të kufijve. Vetëm me njohje reciproke të dy shteteve mund të krijohen kushte dhe mundësi të arrihet një marrëveshje për korrigjim eventual të kufijve por, me kusht se nuk do të rrezikonte qenien dhe interesat e qytetarëve të Kosovës e sidomos do të kundërshtonte korrigjimin e kufijve sipas vijave etnike...". Vetëm ky formulim do të siguronte paqe afatgjatë, normalizim të marrëdhënieve dhe fqinjësi të mirë. Letra e presidentit Tramp e bënte të kundërtën e së dëshiruarës, së paku ashtu e kam lexuar unë, me përgatitje shkollore të mesme dhe kryesisht në gjuhën e Aleksandar Vuçiqit! Nëse del e kundërta e kësaj që e them, për Shën Valentin do t'i dërgojë presidentit Tramp një urim me aq puthje që nuk ia kanë dhuruar të gjitha pornostaret, shërbimet e të cilave i ka paguar avokati i Trampit! Çfarë padrejtësie i bëhet avokatit dhe çfarë privilegji i bëhet Trampit; ju i konsumoni shërbimet, avokati detyrohet të paguaj!

Romeo dhe Xhuljeta, Hashimi dhe Mogerini: Dy histori dashurie, e para e sinqertë dhe idilike, e dyta e interesit dhe politike! E para përfundoi tragjikisht duke e paguar çmimin e dashurisë, e dyta do të përfundojë trupërisht duke e paguar çmimin e dyfytërisë! Frederika Mogerinin nuk e do askush në Kosovë përveç Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Ganimete Musliu nuk është deklaruar ende! As Hajdar Beqa! Këto deklarata për mua nuk përbëjnë asnjë interes! Jetësisht më intereson deklarimi i deputetit Danush Ademi për Frederika Mogerinin për faktin se është personi më aktiv, më i përgjegjshëm dhe më kompe-

tent në Komisionin për Politikë të Jashtme dhe Integritet Evropiane. Po e pres me padurim deklaratën e Danush Ademit, për Frederika Mogerinin. Frederika Mogerini nuk e do askënd në Kosovë. As Hashimin e as Kadrinë të cilët i përdorë dhe këtë e bënte me afat të përdorimit, deri në prill të vitit 2019 pas të cilës datë do të krijojë lidhje të reja interesi dhe pse jo edhe sentimentale. Në Serbi, shumë besoj. Një ish mike imja e që është eksperte e integriteteve evropiane në Tanzani, ditë më parë më qortoi duke më thënë se: "Ti, Behxhet dhe Rambo nuk jeni mirë në kokë që po e kundërshtojmë aq shumë Frederikën e Mogerinëve". Unë e pranove që nuk jam mirë në kokë dhe këtë e mora si rrethanë lehtësuese! Ajo më tha se pikërisht Frederika Mogerini, në një takim me ish miken time na paska lavdëruar shumë neve, përkatësisht Ramushin dhe mua e që sot aq fuqishëm po e kundërshtojmë. Për Ramushin paska thënë se është muskuloz boj lajk Rambo kurse për mua paska thënë se jam bjutiful gej. E Behxhet he bjutiful! Me demek unë po e përkthej në anglisht se jam bjutiful djalë, djalë i bukur dhe i mirë. Ashtu më duket vetja. Një shok afër meje më tha se Mogerini të ka krahasuar me Sikin, doajenin e dikurshëm të Prishtinës që e donin të gjithë. E pyeta një prishtinali të vjetër për veprat që i ka bërë Siki e që e bënin aq të dashur dhe të respektuar në Prishtinën e viteve '70, '80. Pasi ma tregoi historinë e Sikit, e kuptova fjalën gej. Mozomakeq për mua! Hajt baju Frederika Mogerini, ik te Siki, gjendet diku në Serbi. Në një portal dukej se fare nuk kishte ndryshuar, këndonte plotë hare me flokë që i vizëllonin nga çikçovo ulje apo vaji i makinave qepëse Bagat kur nuk kishte para të blinte çikçovo ulje. Anglishtja është gjuhë e çuditshme, nuancat e përcaktojnë nëse je ai që je apo ai që nuk do të jesh! Një shkronjë e vetme!

Dy gjinia apo "burrëreshat" politike të LDK-së: LDK-ja deklarohet si parti institucionale dhe parimore. Është një vetdeklarim. Ka qenë pjesë e të gjitha zhvillimeve në Kosovë, të lavdishme dhe të turpshme, varësisht nga këndi i interpretimit dhe interesit. Edhe sot kërkon dhe siguron vota me ndihmën e varreve. Deklarohet se është parimore dhe se parimet i shkelë vetëm për qëllime të larta, si

parti shtetndërtuese dhe institucionale. Sikur në rastin kur e votoi president Hashim Thaçin për të cilën e ka konsideratën më të lartë e sidomos nëse gjendet në Dyzë apo Hagë. Nëse është në Hagë konsiderata rritet edhe më shumë dhe matet me kohëzgjatjen e qëndrimit në Hagë, si mysafir special i Odave Speciale. LDK-ja e votoi edhe Demarkacionin për shkaqe ekskluzivisht parimore dhe për dobi të institucioneve... të miqve ndërkombëtarë. Jo se i janë bindur kërkesave e lëre më presioneve ndërkombëtare por për shkak të miqësisë! Edhe tash, LDK-ja i pati dhe i ka dy qëndrime për dialogun, Ekipin Negociator dhe Platformën qeveritare për bisedime. Nuk ka pranuar dhe nuk e pranon presidentin Thaçi për udhëheqës të negociatave sepse Thaçi donë t'i jap territor Serbisë kurse LDK-së nuk i mjafton territori deri te Molla e Kuqe por dëshiron të merr edhe territorin e Pakistanit ku jetojnë hundëzakët e Ademit, me prejardhje shqiptare! Idilën patriotike ia prishi një president, jo Hashim Thaçi por Donald Trampi. Tash, LDK-ja, si parti institucionale dhe shtetndërtuese përsëri do t'i shkelë parimet duke kontribuar, si opozitë për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, pa u bërë pjesë e Ekipit Negociator, por, për shkak të interesit shtetërorë dhe miqësisë së përjetshme me SHBA-të të cilën e përfaqëson presidenti Tramp, do ta votojë Marrëveshjen Vuçiq-Thaçi sikur që e votuan Hashim Thaçin president dhe Demarkacionin. Unë jashtëzakonisht i respektoj ata që e çmojnë, kultivojnë, mirëmbajnë dhe e forcojnë miqësinë! Sidomos miqësinë që e ka LDK-ja me Amerikën dhe presidentin Tramp dhe e cila është shumë e sinqertë, deri në mbushje të brekëve! Çfarë pafytyrësie dhe ku shihni ju këtu moral dhe parime!

Narkoza e vizave, mit apo realitet (1)



Shkruan: Agron HOTI

Pse ky shkrim?

Ky shkrim, i cili do të botohet në vazhdim, ka për synim të japë një pasqyrë ndryshe apo, thënë më mirë, një pasqyrë më krahasuese nga ajo që shohim, dëgjojmë dhe lexojmë në lidhje me problematikën e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Shkrimi nuk ka për qëllim të mbrojë e sulmojë askënd, nuk ka për qëllim të relativizojë, neutralizojë, apo absolutizojë asgjë, nuk ka për qëllim t'i bëjë argatin askujt e as qefin dikujt, por vetëm mundohet të pasqyrojë një gjendje të një shteti që sapo ka dalë nga lëvizja e tij dhe nga i cili po kërkohet më shumë sesa, në fakt, ky shtet ka mundësi të ofrojë dhe reflektojë. Po të ishte e lehtë që për 10 vjet shtet të arrihej qeverisje bavarëse apo singapuriene, atëherë krijimi i shteteve të reja do të shënonte shifra rekorde në glob. Por, në një Kosovë me shtetësi ende të pakonsoliduar në rrafshin ndërkombëtar duke mos u njohur nga BE, OKB, NATO, OSBE, Këshilli i Evropës etj., me një Serbi, bisedimet me të cilën absorbojnë tërë elanin politik të Kosovës që së paku 15 vjet duke lënë anash problemet reale me të cilat përballet qytetari çdo ditë, me një të kaluar që mendja e njeriut vështirë se mund të përshkruajë vuajtjet dhe dhimbjet e popullit shqiptar, me rentabilitet dhe resurse të kufizuara për zhvillim ekonomik, me një kompleksitet qeverisjesh vendore dhe ndërkombëtare që vështirë t'i gjendet filli, sigurisht se është utopike të presësh më shumë. Bota e sotme nuk është ajo që ishte dje, e nesërmja do të jetë tepër më ndryshe sesa e sotshmja, e shumë më ndryshe sesa e djeshmja. Përderisa prej 1945-s deri në vitin 1990 kishim një botë bipolare, ku marrëdhëniet ndërkombëtare politike e ekonomike ishin pak a shumë brenda kornizave të një rendi ndërkombëtar, prej vitit 1990 e deri më sot bota është duke u përbërur me një globalizim, i cili edhe pse ishte koncipuar që t'i rrisë shkëmbimet tregtare në shkëmbim të uljes së varfërisë dhe shpërndarjes së pasurisë të të gjithë, ai bëri krejtësisht të kundërtën, rriti monopolet, nxori nga binarët e rendin e

dakorduar ndërkombëtar, nxitu shumë zhvillime kontradiktore dhe polarizoi botën si asnjëherë më parë.

Sipas Foreign Affairs, përderisa para vitit 2006 tri nga gjashtë kompanitë më të fuqishme në glob ishin kompani naftë dhe vetëm një e teknologjisë informative, në vitin 2016 brenda 6 kompanive më të fuqishme në glob mbeti vetëm një e naftës, ndërkohë që pesë të tjerat të gjitha gjigante të teknologjisë informative. Sipas World Economic Forum, janë 20 kompanitë më të fuqishme në glob të teknologjisë informative dhe internetit që prijnë sot në glob për qarkullim financiar vjetor mbi 8 trilionë dollarë, pra larg më shumë sesa ç'fitorjnë kompanitë e naftës dhe industrisë së rëndë.

Intensifikimi i komunikimit në nivel global, rritja e shkëmbimeve tregtare në përmasa të papara, rritja e monopoleve anekënd globit kanë filluar ta godasin qëllimin e globalizimit për një botë të hapur dhe pa barriera. Dhe këtë e ka mundësuar pikërisht interneti. Nuk ka shtet në botë që sot të mos jetë i cenusur nga sulme të ndryshme kibernetike. Siguria e të dhënave personale kurrë nuk ka qenë më e rrezikuar. Pra, këto janë vetëm disa nga sfidat me të cilat është duke u përbërur bota. Edhe Kosova nuk përbën përjashtim. Prandaj, në vend se Kosova të jetë pjesë e rrjeteve të ndryshme rajonale, e globale ajo vazhdon të mbetet e izoluar, e izolimi i vjen pikërisht nga projekti evropian, për të cilin Evropa ka ëndërruar me shekuj të tërë.

Kërkesat e BE-së ndaj Kosovës për liberalizimin e vizave janë sikur kur i kërkon një djaloshi/vajze 10-vjeçar/e që të vrapojë apo punojë sa një burrë/grua 20 vjeçar/e, diçka që anatomia e organizmit të njeriut nuk mund ta bëjë. Dhe meqë dhe shteti është si anatomia e organizmit të njeriut, atëherë është e pamundshme që një shtet i ri, me një të kaluar tepër të dhimbshme, me një mjedis rajonal të paqëndrueshëm, me një dinamikë globale që sot askush s'e kupton plotësisht, të arrijë që për 10 vjet shtet të hyjë në konkurrencë me shtete që ekzistojnë që mbi 300 vjet e më gjatë.

Sigurisht se Kosova ka shumë probleme, por probleme - bile të mëdha - kanë edhe demokracitë më të fuqishme në glob. Fakti që shtetet me traditë nuk ia kanë dalë, e as që do t'ia dalin ndonjëherë, të krijojnë mjedis pa probleme, tregon se Kosova ka një rrugë të gjatë para vetes, shumë të gjatë, për të hyrë në

konkurrencë me demokraci të zhvilluara. Një mendje e ftohtë e kupton që një fëmijë i lindur nuk mund të rritet për një ditë, por duhen vite për këtë, pra duhet rrjedha normale. Edhe shteti i lindur rishtazi nuk është më ndryshe, pra duhet të fillojë të ecë, të zhvillohet dhe të hyjë në konkurrencën rajonale e globale që nuk përfundon kurrë.

Mirëpo, ky shkrim nuk ka për qëllim të ngacmojë, lëmojë apo ledhatojë askënd, pra as atë që e pëlqen apo s'e pëlqen këtë shkrim. Krejt në të kundërtën shkrimi është merr e le sa të duash gjithnjë duke reflektuar për alternativa që i shërbejnë debatit publik për temën e liberalizimit të vizave që vazhdon ta mbajë shoqërinë e Kosovës në narkozë të pafundme, ndërkohë që bota është duke bërë hapa gallopantë drejt zhvillimit dhe prosperitetit.

Evropa e Re

"Asnjë popull tjetër i botës nuk është aq i panjohur për evropianët e Perëndimit për sa i përket prejardhjes, historisë dhe gjuhës sa shqiptarët. E, megjithatë, ata janë popuj kryesorë, të lashtë e të rëndësishëm, që çdo historian do të dëshironte t'i njohte: historia e tyre do të plotësonte zbrazëti të mëdha në historinë e vjetër e të re të Evropës. Por... ata sot nuk luajnë më ndonjë rol të veçantë. Ata janë të nënshtruar, ata janë fatkeq dhe historiani shpesh është po aq i padrejtë, sa dhe njeriu i zakonshëm; ai nuk i përfill ata, të cilëve nuk iu ka prirë fati" (Johan Tunman, 1774, Leipzig, "Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore"). E fati dhe fakti që ishim "kryesorë" dhe "të lashtë" pothuaj asnjëherë nuk u mor parasysh nga Evropa. Nuk ka as edhe një popull të vetëm në Evropë të jetë dëmtuar më shumë sesa shqiptarët pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Përderisa Evropa pas Luftës së Dytë Botërore bënte plane për integrimin e gjithëmbarshtëm të saj, së paku të asaj pjese perëndimore që ishte nën bllokun e NATO-s, shqiptarët e mbetur në hapësirat e ish-Jugosllavisë po terrorizoheshin para syve të botës dhe po depërtoheshin në Turqi. Shkaku i mosprishjes së balancave mes Perëndimit dhe Lindjes qytetarët shqiptarë brenda hapësirave të ish-Jugosllavisë paguan çmimin më të rëndë që mund të paguajë një popull, e që ishte dhuna e terrori konstant para dhe për gjatë tërë trajektore jugosllave.

Drama maratone e lëvizjes së lirë të njerëzve brenda Evropës kishte filluar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, duke u parë si nevojë e domosdoshme

për ta rritur komunikimin mes popujve si mundësia më e mirë për t'i qetësuar mendjet e nxehta që kishin terrorizuar Evropën shekuj me radhë. E tëra fillon më 19 shtator 1946 në Universitetin e Cyrihut, kur Winston Churchill, Udhëheqësi Konservator Britanik, kërkonte pajtimin gjermano-francez dhe krijimin e një Organizate Evropiane si kusht për paqe dhe liri në gjithë kontinentin evropian.

E dërrmuar nga Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, Evropa nga reaktive ndezi motorët për t'u bërë pro-aktive duke ndërmarrë një sërë hapash, të cilët kishin një qëllim të vetëm: afrimin e popujve evropianë që ndër shekuj ishin hasmuar me luftëra të pafundme dhe dërrmuese. Në këtë drejtim u themeluan Këshilli i Evropës, Organizata Evropiane për Bashkëpunim Ekonomik (OEEC më vonë OECD), Komuniteti Evropian për Thëngjill dhe Çelik (ECSC), Komuniteti Ekonomik Evropian (EEC), NATO, OSBE, Politikë Ekonomike dhe Monetare të BE-së (EMU), Unioni Doganor, Tregu i Përbashkët i BE-së, Marrëveshja e Schengenit, Traktate të ndryshme, deri te Traktati i Lisbonës. Gjithsesi që të gjitha këto arritje as që do të mund të paramendoheshin pa mbështetjen e ShBA-së, interesi i së cilës ishte luftimi i komunizmit.

Sigurisht se në këtë vazhdë BE-ja kishte edhe dështimet e veta. Ndër më kryesoret janë kundërshtimi francez i vitit 1954 për mosthemelimin e Komunitetit Evropian për Mbrojtje nga frika e rimilitarizimit të Gjermanisë Perëndimore. Vlen të theksohet se ishte vetë Franca e cila kërkonte një lloj ushtrie evropiane përballë kërcënimeve të Bashkimit Sovjetik dhe në fund pati votuar kundër. Dështim tjetër ishte edhe mosmiratimi i Kushtetutës së BE-së si rezultat i referendumit kundërshtues në Holandë dhe Francë në maj 2005.

Pa marrë parasysh të metat, projekti i BE-ë, vazhdonte të shënonte progres deri në krizën financiare globale të vitit 2008 dhe krizën e refugjatëve sirianë gjatë vitit 2015 dhe 2016, e cila i dha goditjen më të madhe projektit evropian. Filloi me krizën greke, vazhdoi me Brexit dhe është duke vazhduar me rritjen e forcave populiste dhe nacionaliste gjithandej BE-së. Se si do të duket BE-ja në vitet që vijnë mbetet të shihet, edhe pse për ne s'ka alternativë.

Se sa i rëndësishëm ishte Projekti Evropian këtë e proklamonte edhe Margaret Thatcher më 20 shtator 1988 në hapjen e vitit akademik pranë College of

Europe në Bryzh të Belgjikës, e cila fliste në një moment kyç të debatit mbretëruar të saj asaj kohe të Britanisë së Madhe për të ardhmen e Evropës, ku kishin filluar të rriteshin zërat se në Britani të Madhe kishte lindur lëvizja euro-skeptike. Pra, lëvizjet në ardhje drejt bashkimit të Gjermanive, jepnin perceptonin që brenda kontinentit evropian shumë shpejt do të prisheshin balancat e fuqive, sepse një Gjermani e bashkuar do të kishte, ndër të tjera, armatën më të madhe në Evropë, diçka që nuk mund të pranohej lehtë nga Franca dhe Britania e Madhe.

Zelli integruar

Pa marrë parasysh perceptonin dhe zhvillimet politike, BE-ja asnjëherë nuk ndali hapat integruar siç ishte qëllimi për lëvizje të lirë të njerëzve brenda një hapësire të caktuar. Më konkretisht, pesë shtete (Belgjia, Franca, Gjermania perëndimore, Luksemburgu dhe Holanda) në vitin 1985 patën nënshkruar Marrëveshjen e Shengenit me qëllim të garantimit të lëvizjes së lirë të njerëzve brenda territorit të këtyre pesë shteteve.

Vetëm pas 10 vjetëve angazhim maratonik të BE-së, pra më konkretisht në vitin 1995, kjo marrëveshje kishte arritur të hynte në fuqi, duke ngërthyer në vete edhe Spanjën dhe Portugalinë dhe duke e rritur numrin e shteteve anëtare nga 5 në 7. Sot hapësira e Shengenit ngërthen në vetvete 26 shtete, 22 nga të cilat janë shtete anëtare të BE-së. Përpos shteteve anëtare, hapësirën e Shengenit e shfrytëzojnë edhe të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës.

E Bullgaria, Rumania dhe Kroacia ende nuk janë anëtare të Shengenit, edhe pse janë anëtare të BE-së. Zvicra dhe Norvegjia, edhe pse nuk janë anëtare të BE-së, janë pjesë e Shengenit. Britania e Madhe, edhe pse anëtare e BE-së (deri në mars 2019), nuk ishte anëtare e Eurozonës dhe Zonës Schengen. Pra, siç shihet, BE-ja ka një sërë kombinimesh të ndryshme saqë nganjëherë është e vështirë të dihet se kush ku është. Megjithatë, kompleksiteti i BE-së nuk është në fokusin e këtij shkrimi. Përqendrimi këtu ka të bëjë me dramën maratone të vizave për qytetarët e Kosovës si të vetmit qytetarë të Evropës që ende nuk gëzojnë lëvizjen e lirë të premtuar, diçka që shkon në kundërshtim të plotë me procesin e hapjes dhe zgjerimit të procesit të integritit evropian në tërësinë e tij.

(Vijon)

ShBA-ja vendos sanksione të reja ndaj Rusisë për ndërhyrjen në zgjedhje



UASHINGTON, 20 DHJETOR - Administrata Trump vendosi sanksione të reja ndaj zyrtarëve dhe subjekteve ruse lidhur me ndërhyrjen në zgjedhje si dhe rreth atyre që Departamenti i Thesarit i quan aktivitete të tjera keqdashëse. Ato përfshijnë dyshimet rreth tentativës për vrasjen e një ish-agjenti rus dhe vajzës së tij në Britani. "ShBA-ja do të vazhdojë të punojë me aleatët dhe partnerët e tyre për të

penguar dhe për t'u mbrojtur ndaj veprimtarisë së vazhdueshme keqdashëse të Rusisë", tha sekretari i Thesarit, Stiven Mnuchin. Mes atyre ndaj të cilëve janë vendosur sanksione janë 15 agjentë të zbulimit ushtarak dhe katër njësi qeveritare, përfshirë Agjencinë e Kërkimit në Internet. Sipas një raporti të ri dorëzuar Senatit amerikan këtë javë thuhej se kjo agjenci përdorte çdo plat-

formë të madhe të medieve sociale për t'i ndikuar votuesit në vitin 2016 për t'i hedhur votat për Donald Trumpin si dhe për t'i keqinformuar votuesit që nuk kishin gjasë ta mbështesnin atë, duke i dekurajuar të votonin. Sanksionet e së mërkurës godasin edhe ata që hakëruan Agjencisë Botërore kundërdoping-ut, Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike dhe agjenci të tjera jopolitike.

Aleatët nuk pajtohen për tërheqjen e trupave të ShBA-së nga Siria

Njoftimet për tërheqje të plotë të trupave të ShBA-së nga Siria kanë nxitur kritika të menjëhershme nga disa prej republikanëve të partisë së tij, të cilët kanë thënë se një hap i tillë i fuqizon Rusinë dhe Iranin, të cilat e mbështesin presidentin sirian Bashar al Assad

UASHINGTON, 20 DHJETOR - Presidenti amerikan Donald Trump ka nisur atë që do të jetë tërheqje e plotë e trupave amerikane nga Siria, pasi ka deklaruar të mërkurën se ata kanë përfunduar me sukses misionin e tyre kundër grupit militant, Shteti Islamik, dhe këta trupa nuk janë më të nevojshëm në këtë shtet. Vendimi për t'u larguar plotësisht, siç është konfirmuar nga zyrtarët amerikanë dhe që pritet të ndodhë në muajt vijues, tregon se 2.000 trupat amerikane kanë përfunduar fushatën duke rifituar kontrollin e territorit që dikur kanë zotëruar militantët e IS-it. Mirëpo një vendim i tillë nuk i jep shumë mundësi ShBA-së për të parandaluar ndonjë kryengritje tjetër të IS-it. Një gjë e tillë, po ashtu, do ta zvogëlonte ndikimin amerikan në rajon dhe do t'i dëmtonte përpjekjet diplomatike për t'i dhënë fund luftës në Siri, e cila tashmë ka hyrë në vitin e tetë. "Ata të gjithë do të kthehen dhe do të kthehen tani. Ne kemi fituar", ka thënë Trumpi të mërkurën në një video të postuar në rrjetin social "Twitter". Lajmet për tërheqje të plotë kanë nxitur kritika të menjëhershme nga disa prej republikanëve të partisë së tij, të cilët kanë thënë se

një hap i tillë e fuqizon Rusinë dhe Iranin, të cilat e mbështesin presidentin sirian Bashar al Assad. Një gjë e tillë, po ashtu, mund të lë të pambrojtur aleancën e kurdëve dhe arabëve të njohur si Forcat Demokratike Siriane (SDF), të cilët kanë qenë në mesin e forcave më efikase kundër militantëve të IS-it, mirëpo këto forca tani janë duke u përballuar me një ofensivë të re të Turqisë në Siri. Forcat Demokratike Siriane kanë paralajmëruar të enjten se vendimi i befasishëm i Trumpit për t'i tërhequr trupat amerikane do t'u japë hapësirë militantëve të Shtetit Islamik që të fuqizohen. Përveç të tjerash, këto Forca kanë thënë se një hapësirë e tillë ushtarake mund të rezultojë me ambient armiqësor mes palëve në Siri. Megjithatë, Trumpi ka thënë se ai e konsideron të përfunduar misionin e ShBA-së në Siri, mirëpo Shtëpia e Bardhë nuk ka ofruar të dhëna se kur mund të ndodhë tërheqja e plotë. Një zyrtar amerikan ka thënë se Uashingtoni synon t'i tërheqë trupat brenda 60 deri në 100 ditë dhe kanë thënë se Departamenti amerikan i Shtetit do ta evakujë të gjithë personelin nga Siria brenda 24 orëve.



Lajm i papritur

Trumpi duket se është i vetëdijshëm për konfliktet afatgjatë dhe vendimi i tij për Sirinë ka ngritur pyetjet nëse ai do t'i rikonsiderojë përpjekjet amerikane në Afganistan, ku forcat amerikane kanë luftuar nga viti 2001. Trumpi ka rritur numrin e trupave në Afganistan vitin e kaluar, mirëpo zyrtarët amerikanë e kanë pranuar privatisht nevojën urgjente për të siguruar paqe me talibanët, transmeton "Reuters". Disa nga republikanët që janë aleatë më Trumpin kanë kundërshtuar tërheqjen e trupave. Senatori amerikan Lindsey Graham, zakonisht përkrahës i Trumpit, ka thënë se tërheqja e trupave do të ketë "pasoja

shkatërruese" për Shtetet e Bashkuara dhe për rajonin në gjithë botën. "Një tërheqje amerikane në këtë kohë do të jetë fitore e madhe për IS-in, Iranin, Bashar al-Assadin dhe Rusinë", ka thënë Graham përmes një deklaratë. Një vendim i tillë ka qenë befasia edhe për liderë të tjerë botërorë. Ministri britanik i Mbrojtjes ka thënë se ai nuk pajtohet me qëndrimin e Trumpit se është mposhtur Shteti Islamik derisa zyrtarë izraelitë kanë thënë se Izraeli do ta studiojë vendimin dhe do ta garantojë sigurinë e tij. Në Rusi, agjencia e lajmeve TASS ka cituar Ministrinë e Jashtme të ketë thënë se tërheqja e trupave amerikane nga Siria ka krijuar perspektivë për zgjedhje politike.

Njëpërçindëshi i fundit

Grupi militant Shteti Islamik ka shpallur të ashtuquajturin "kalifat" më 2014, pasi ka fituar kontrollin e disa pjesëve në Siri dhe Irak. Përveç të tjerash, ky grup ka shpallur edhe qytetin sirian, Raka, si kryeqytet të kalifatit, duke e shfrytëzuar këtë zonë për të organizuar sulme në Evropë. Një zyrtar amerikan ka thënë javën e kaluar se grupi tashmë zotëron vetëm një për qind të territorit që ka pasur dikur. Megjithatë, zyrtarët amerikanë kanë paralajmëruar se rimarrja e territorit nga IS-i nuk është e njëjtë sikurse mposhtja e grupit. "Koalicioni ka çliruar territorin e zotëruar nga IS-i, mirëpo fushata kundër këtij grupi nuk ka përfunduar", ka thënë zëdhënësjja e Pentagonit, Dana White, në një deklaratë.

Putini përshëndet vendimin e presidentit Trump për Sirinë



MOSKË, 20 DHJETOR - Presidenti rus Vladimir Putin përshëndeti vendimin e presidentit Donald Trump për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria, duke përsëritur qëndrimin e qeverisë së tij se forcat e ShBA-së nuk janë të mirëpritura në Siri. Ai përmendi praninë e ShBA-së në Afganistan për të shprehur skepticizëm nëse trupat amerikane në Siri vërtet do të largohen. Reagimet e tjera ndërkombëtare ndaj njoftimit amerikan ishin të

ndryshme. Britania vuri në dukje përparimin e bërë në luftën kundër ISIS-it, Franca u zotua të vazhdojë luftën, kurse Gjermania tha se tërheqja mund të rrezikojë suksesin e arritur deri tani. As Shtëpia e Bardhë dhe as Pentagoni nuk thonë se sa kohë do të duhet për tërheqjen pa probleme të të gjitha forcave amerikane nga Siria. Sipas vlerësimit të Pentagonit në gusht të këtij viti, ISIS kishte ende të

paktën 13 mijë luftëtarë në Siri. Tërheqja e Shteteve të Bashkuara gjithashtu ngre pikëpyetje për fatin e qindra luftëtarëve të huaj të ISIS-it që mbahen në paraburgim nga forcat kurde dhe që shumë qeveri kanë refuzuar t'i pranojnë. Edhe me një tërheqje të përgjithshme të ShBA-së nga Siria, Ushtria amerikane mbetet përsëri me një prani të konsiderueshme në rajon, duke përfshirë më shumë se pesë mijë trupa në Irakun fqinj.




BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

Porositi midhje në restorant, gjen perlën që kushton mbi 2 000 euro



Shkon për darkë në një restorant dhe porositi një pjatë me midhje që kushtonte rreth 13 euro dhe në njëren prej tyre gjen një perlë që mund të vlejë 2 mijë deri në 4

mijë euro. Kjo është surpriza që i ka ndodhur 66-vjeçarit Rick Antosh, në një restorant në qendër të Nju Jorkut në Manhattan.

FOTO E DITES



Një zjarr në një fabrikë të pëlhurave ka detyruar autoritetet t'i pezullojnë operacionet në aeroportin e qytetit dhe në rrugët e afërta në Toluca, Meksikë. Fotografia nga: EPA.

E rrallë

Gjen 1 750 euro, merr shpërblim nga pronarja një panetone



Gjen një çantë me para dhe vendos që ta dorëzojë, 30-vjeçari merr shpërblim vetëm një panetone. Historia ndodhi në Crema, në krahinën e Kremones, ku

protagonist i kësaj historie është një 30-vjeçar, i cili i ka kthyer 1 750 euro pronarit legjitim. Një grua 68-vjeçare kishte tërhequr paratë nga banka për t'i blerë dhuratat


e Krishtlindjes. Tridhjetëvjeçari nuk pranoi shpërblimin që i ofroi zonja, 10 për qind të kësaj shume, por pranoi një panetone si shenjë mirënjohje.



DASHI
Karakter i juaj sot nuk përkon fare me atë çfarë jeni në të vërtetë. Arrogant dhe egoist, sot do të shkaktoni shumë hatërmbetje rreth jush.



DEMI
Partneri po bëhet një pengesë për karrierën tuaj sepse në shumë raste duke kërkuar praninë tuaj ju ka bërë të hiqni dorë nga oportunitete mjaft të mira.



BINJAKËT
Asgjë nuk do t'ju vijë si dhuratë sot. Gjithçka do t'ju duhet ta fitoni vetë me shumë mund dhe punë. Por, përvoja që do të krijoni do të ketë vlerë.



GAFORRJA
Shumë persona ju kanë paragjykuar pa parë atë që keni bërë me vepra. Sot do të ndryshojnë mendim dhe do të ketë nga ata që do t'ju kërkojnë falje.



LUANI
Një çështje disi bezdisëse do t'jua tërheqë vëmendjen sot. Nuk keni dashur të jeni pjesë e saj, por ju kanë përfshirë pa ju pyetur.



VIRGJËRESHA
Familja ju ka përgatitur një surprizë të këndshme që do t'ju kënaqë. Pasditja do të kalojë në shoqëri të mirë dhe biseda interesante.



PESHORJA
Këto kohë ju tërheq çdo gjë që ka të bëjë me kulturën dhe artin. Njohuritë tuaja keni dëshirë t'i thelloni më shumë me kurse dhe leksione jashtë.



AKREPI
Keni mosmarrëveshje me pjesëtarët e familjes dhe kjo gjë nuk po ju lë të qetë. Këtë moment doni të përqendrohni për të zgjidhur një çështje të caktuar.



SHIGJETARI
Sot do t'ju vë në siklet një situatë e caktuar. Do t'ju ngelen në mendje për shumë kohë momentet e sikletshme që provuat.



BRICJAPI
Shoqëria juaj ju ka rezervuar një darkë interesante sot që kishit ditë që e prisnit. Përgatituni të merrni edhe dhuratat të këndshme.



UJORI
Problemi më i madh sot do të jetë me financat tuaja. Të gjitha fushat e tjera të jetës shkojnë mjaft mirë dhe ju ndiheni të qetë.



PESHQIT
Jeni të dyzuar sot nëse do t'i merrni gjërat siç vijnë apo do ta programoni ditën për të mos pasur surpriza. E rëndësishme është të vendosni.

BARSOLETA E DITËS



Dhëndëri e përcjellë vjehrrën në aeroport. Dhe pasi vjehrra hip në avion, dhëndëri i lutet Zotit: "O Zot merre, tani e ke më afër!"



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Pasurinë 25 milionëshe të Aviciit do ta trashëgojnë prindërit e tij



DJ i njohur, Avicii, emri i vërtetë i të cilit është Tim Bergling, u gjet i vdekur në atë që u tha se ishte vetëvrasje në muajin prill të vitit 2018, në afërsi të Muskatit, Oman. Tani pasurinë e tij

në vlerë prej 25 milionë eurosh do ta trashëgojnë prindërit e tij, Anki Liden dhe Klas Bergling. Prindërit e DJ-it të njohur do t'i marrin të gjitha paratë që mbetin pas pagesës së të gjitha taksave.

"Forbes"-i shpall modeluesen më të paguar për vitin 2018



Kendall Jenneri është shpallur modeluesja më e paguar në botë nga "Forbes". Ylli i pasarelave siguroi 22.5 milionë dollarë në 12 muaj. Ajo mundi supermodelueset dhe miket e saj

Bella e Gigi Hadid, si edhe Karlie Klose e Gisele Bundchen. Të ardhurat e Jennerit janë siguruar nga partneriteti i saj fitimprurës me markat e mëdha "Adidas", "Estee Lauder" dhe "Calvin Klein".



Fansat kritikojnë të fejuarën e Ronaldos

Cifti Cristiano Ronaldo-Georgina Rodriguez është një superfuqi sa i përket popullaritetit në rrjetet sociale. Modeluesja ka marrë pjesë në disa ngjarje të rëndësishme të modës, duke zënë edhe faqet e para të revistave. Gjithsesi, fotografia e fundit që ka

publikuar Georgina ka nxitur reagime nga më të ndryshmet. Disa komentues kanë vënë në dyshim edhe shijet e saj. "Është shumë tërheqëse, por personalisht mendoj se ka nevojë për dikë që ta këshillojë për stilin, me paratë që ka...", ishte një nga komentet.

Kris Jenneri i blen nipit xhaketë 3000 dollarëshe

Vetëm disa ditë pasi i mbushi nëntë vjet, Mason Disick ka treguar se ka një shije goxha ekstravagante. I biri i Kourtney Kardashianit dhe Scott Disickit ka pranuar një dhuratë shumë të veçantë nga gjyshja e tij Kris Jenner derisa po blinin për Krishtlindje në Beverly Hills. Jenner, si një gjyshe tipike, duket se nuk e ka menduar dy herë para se të shpenzojë 3000 dollarë në një xhaketë të markës së njohur "Versace", për nipin e saj.



Nënshkruhen kontratat për financimin e 70 ndërmarrësve të rinj

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Në kuadër të Planit të Veprimit për Rritjen e Punësimit për të Rinj, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar në kabinetin e tij kontratat për 70 ndërmarrës të rinj nga skema e granteve për fillim të bizneseve të reja, pas përfundimit të procesit të trajnimit për ndërmjetësim, proces i cili është mbështetur nga MKRS-ja, ku 400 të rinj janë trajnuar nga ky program i trajnimit.

Skema e ndërmarrësisë do të sigurojë ndihmë me grante në vlerë prej 3 000 deri 5 000 euro për çdo plan biznesi të zhvilluar me sukses që është miratuar në

kuadër të procesit të përzgjedhjes. "Edhe 70 të rinj përfitojnë nga skema e granteve për start-up. Nga ky fond janë mbështetur të rinjtë të cilët paraprakisht kanë ndjekur trajnimin për ndërmjetësimin në punë dhe procesin e dhënies së granteve për t'i hapur bizneset e tyre duke krijuar një rrjet të sipërmarrësve të rinj", ka sqaruar ministri Gashi, duke thënë se këta 70 të rinj do të jenë një potencial jo vetëm për familjen e rrethin ku do të veprojnë, por edhe për Republikën e Kosovës në instancë të fundit. "Objektivi kryesor i programit është të sigurojë mundësi për të rinjtë e

papunë për ta nisur një veprimtari biznesi", ka deklaruar ministri.

Këto trajnime në ndërmarrësi u kanë mundësuar të rinjve procesin e kthyer nga një ide në një fillim të suksesshëm biznesi. Projekti është fokusuar ekskluzivisht në krijimin e sipërmarrësve të ardhshëm, si dhe fuqizimin e bashkëpunimit në mesin e të rinjve duke krijuar një rrjet të sipërmarrësve. "Si ministri jemi jashtëzakonisht të fokusuar për përkrahjen e të rinjve të cilët me propozimet e tyre kanë filluar një cikël të ri të krijimit të bizneseve", ka thënë në fund ministri Gashi.



MKRS-ja ka rritur përkrahjen për rininë

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Në një ceremoni të organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë ndarë certifikata të aftësisë profesionale për punë në sektorin e mobilierisë - montim dhe shitje. Dhënia e këtyre certifikatave është bërë pas aftësisë profesionale të të rinjve, realizuar në kuadër të programit "Rritja e punësimit përmes zhvillimit të ndërmarrësisë".

Me anë të këtij programi për sektorin e mobilierisë janë trajnuar më shumë se 130 të rinj nga komuna të ndryshme në vendin tonë. Me këtë rast, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, u shpreh i lumtur me realizimin e këtij programi dhe, po ashtu,



shprehu falënderime të veçanta për bizneset që kanë mundësuar punën praktike e për të cilët u ndanë certifikata dhe për përfituesit e projektit. "Ministria e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit, progresivisht ka rritur përkrahjen për rininë, në veçanti në vitet e fundit. Qëllimi i realizimit të projekteve të tilla është që të

rinjtë të aftësohen në mënyrë që të jenë ekonomikisht të përgjegjshëm dhe të pavarur e kështu që të rinjve të vendit tonë t'u mundësohet ta njohin botën e tyre të brendshme dhe mjedisin që i rrethon", ka thënë ai.

Ministri Gashi ka theksuar se si ministri janë mekanizëm i rëndësishëm për t'i ndihmuar të rinjtë për tregun e punës. "Nga ky projekt 12 të rinj tashmë janë punësuar. Kjo është edhe një arsye shtesë që në vitin 2019 ta kemi fondin edhe më të madh sa i përket aftësisë profesionale të të rinjve, por edhe përgatitjes së tyre për tregun e punës", ka thënë ai. Ministri Gashi ka theksuar

edhe pjesëmarrjen e gjinisë femërore që në këtë program pjesëmarrja e tyre ka qenë prej 54 përqindësh duke e cilësuar këtë si lajm jashtëzakonisht të mirë.

Ndërkaq përfaqësuesit e bizneseve dhe përfituesve të projektit, për të cilët u ndanë certifikata, u shprehën të kënaqur për këtë bashkëpunim dhe, sipas tyre, realizimi i një programi të tillë ka rezultuar të jetë i suksesshëm për aftësimin e të rinjve. Po ashtu, ata u shprehën të gatshëm për të bashkëpunuar edhe në të ardhmen me Ministrinë, në mënyrë që të rinjtë e vendit të përfitojnë nga aftësimi dhe të përgatiten mirë profesionalisht për të hyrë në tregun e punës.

Koordinatori Hoti: Është obligim që diaspora të jetë pjesë e Programit Nacional për Rininë

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, i shoqëruar nga e ngarkuara me punë në Ambasadën e Kosovës në Londër, Heroina Telaku, ka zhvilluar takim zyrtar me udhëheqësit e shoqatave shqiptare dhe shkollave shqipe që veprojnë në Londër të Anglisë si "Kosova", "Faik Konica", "Qendra Shqiptare", "Nëna Terezë" etj.

Hoti para tyre shpalosi Programin Nacional për Rininë i cili parasheh përfshirjen e nxënësve dhe studentëve shqiptarë të diasporës në garën e nivelit republikan. "Jam shumë i lumtur që para jush po prezantoj një program për rininë dhe një program që brenda tij parasheh edhe pjesëmarrjen e diasporës. I

kemi përfshirë edhe nxënësit tuaj në program sepse mërgata ka një rëndësi të veçantë për vendin, sepse ju jeni pjesë e pandashme e atdheut. Nëpërmjet këtij programi presim që të rinjtë shqiptarë që jetojnë në Angli të vijin në Kosovë për të garuar me bashkëmoshatarët e tyre. Ky program do t'u mundësojë atyre një komunikim më intensiv dhe atraktiv me atdheun në të gjitha garat që ata do të marrin pjesë", ka thënë koordinatori Hoti, duke shtuar se Kosova e ka për obligim dhe është duke punuar në atë drejtim që diasporën të mbetet pjesë e pandashme e saj.

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport u premtoi shoqatave se do t'ua sjellë të përkthyerat testet edhe në gjuhët në të cilat nxënësit e



mërgatës e zhvillojnë mësimin. E përfaqësuesit e shoqatave shqiptare që veprojnë në Londër, duke përgëzuar Koordinatorin Hoti për Programin, u shprehën

të lumtur që fëmijët e diasporës do të përfshihen në Programin Nacional për Rininë. Ata theksuan se diaspora ka shumë talentë të cilët kanë nevojë për t'u

nxitur për të marrë pjesë në gara dhe për ta dëshmuar veten si dhe u shprehën të gatshëm të ndihmojnë për implementimin e programit.

Lamtumirë pagjumësi, 10 këshilla për të fjetur të qetë

Shumë probleme, shumë mendime ... mjaft më net të trazuara: ja disa këshilla të dobishme për të gjetur gjumin tuaj të humbur

Festat po afrohen, por problemet nuk heqin dorë: kështu, përveç lodhjes së punës dhe një jete plot angazhime, shtohen edhe netët që duken si makth, ku drita e diellit nuk duket se do të vijë dhe kur bie alarmi, me ndihemi të lodhur edhe pa filluar dita. Këtu është një udhëzues i dobishëm për të pushuar më mirë dhe për të arritur te Krishtlindjet me një mendje më të qetë dhe një rezervë të mirë energjie.

1.Takim në darkë: të darkoni natën vonë absolutisht duhet shmangur. Metabolizmi ynë ngadalësohet në fund të pasdites, kështu që është praktikë e mirë të mos shkoni të flini të rënduar nga vakti, kë shtu që lehtë soni tretjen, duke përshtuar orarin e darkës, e cila duhet të jetë ushqyese, por e lehtë.

2.Ushqimi i duhur: supërat janë të përsosura, sepse ato ju hidratojnë dhe ju ngopin me shije pa ju rë nduar shumë, por mbi të gjitha ju ngrohin edhe nga brennda. Pastaj nëse duam edhe ëmbëlsirë, ne mund të përgatisim mollët në furrë: me një spërkatje të kanellës ata do të jenë të shijshme dhe të lehta.

3.Përfitime rituale: të kënaqeni në një banjë të nxehtë është një mënyrë e jashtëzakonshme për t'u kujdesur për veten dhe gjithashtu një kënaqësi që është e aftë menjë herë të na qetësojë trupin dhe mendjen. Këshilla e mençur? Hedhim në ujë disa pika vaj esencial: perfekt për lirim e blloqeve të muskujve dhe lirim e tensionit.

4.Dhjetë minuta në heshtje: një dritë e butë, muzikë relaksuese

dhe një pozicion komod: nuk duhet të mungojnë kë to gjëra kur duhet të clodhemi. Frymëmarrja e thellë ndihmon të çlirohemi nga tensionet dhe të qartësojmë mendjen nga mendimet dhe emocionet. Një çast i qetësisë së brendshme është i përsosur për të kaluar drejt gjumit të qetë.

5.Harrojeni teknologjinë: më mirë i shmangni tabletat dhe kompjuterat gjatë orëve të mbrëmjes: ata tërheqin vëmendjen dhe na bëjnë që të kalojmë kohën e fjetjes. Në fund të ditës ne preferojmë meloditë e ulëta ose zero, do të jetë me të vërtetë një ilaç për mendjen: meritojmë pak relaksim, nuk duhet ta harrojmë!

6.Buzëqeshni se ju kalon: Aromaterapia mund të jetë një ndihmë e madhe për të na dhënë një atmosferë qetësie dhe humor të mirë. Le të përqijemi me esencat e mandarinës dhe portokallit të ëmbël, të cilat sipas studimeve luftojnë stresin dhe nervozizmin duke

nxitur qetësinë dhe gëzimin: le t'i vendosim në difuzor në pasditen e vonë, kështu që kur të futemi në shtëpi do të ndiejmë një aromë të veçantë dhe do të ndihemi të relaksuar.

7.Kënaqësitë dhe pasionet – të kesh një hobi ul nivelin e stresit dhe ndihmon për t'u clodhur: kjo është ajo që del nga hulumtimi, por edhe se sa mund të përrjetojmë në çdo herë që i kushtohemi dickaje që na pëlqen dhe na argëton. Në kuzhinë gjithçka është me vlerë, sepse na bën të ndjehemi mirë.

8.Për gjumë qetësues: për të pushuar më mirë dhe për të siguruar një gjumë të thellë, duke e bërë më të lehtë zgjimin energjik, provoni përdorimin e vajit thelbësor të livandos. Kundër dhimbjeve të qafës së mitrës dhe relaksimit të muskujve do të jetë e mjaftueshme për të shtuar disa pika vaj esencial në jastëk tonë: aq shumë parfum të pastër dhe të freskët, si dhe relaksim të garantuar.

9.Ritualet e natës së mirë: një infuzion është perfekt si ritual para se të shkoni në shtrat. Kamomili është i shkëlqyer për të na vënë në gjumë. Këshilla e mençur? Hidhni disa pika çaji bimor në pambuk dhe vendoseni butësisht mbi qepalla: do të jenë një ilaç i vërtetë për t'u dhënë ndihmë syve të lodhur dhe të fryrë.

10.E mbyllim për bukuri: oh mirë, se seksi është një qetësues i fuqishëm dhe një pilulë e pabesueshme e gjumit sigurisht që nuk është një mister. Për shembull, për të garantuar një natë të qetë, ne mund të kemi një masazh të ndërsjellë me partnerin, ndoshta duke përdorur një vaj vegjetal dhe disa pika vaj esencial kamomili. Përkëdheljet dhe përqafimet janë ideale për të hequr tensionet dhe për të na bërë të ndihemi të dëshiruar dhe të përkëdhelur: të dashur dhe të pamaskuar: më e mira për një natë të mbushur me ëndrra të bukura dhe një pushim manual.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

WOLVERHAMPTON - LIVERPOOL

2

REAL SOCIEDAD - ALAVES

1

PARIS - RED STAR

GG

Haradinaj: Hendbolli ynë t'i arrijë majat e hendbollit botëror

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, është optimist se hendbolli i Kosovës shumë shpejt do t'i arrijë majat e hendbollit botëror. "Nuk është lehtë të jesh sportist në Kosovë, një vend që është i ri, me sfida. Disa nga sportistët tanë kanë prekur majat botërore, disa të tjerë janë ende të sfiduar për t'i arritur ato maja, por i uroj hendbollit kosovar, Federatës së Hendbollit të Kosovës për suksese, që jo vetëm se do të mburremi në rajon e më gjerë, por edhe të arrijmë majat e hendbollit botëror", ka thënë Haradinaj



Një lajm i mirë në këtë ditë feste për hendbollin e Kosovës ishte ai që e dha kryeministri Haradinaj, se Qeveria e Kosovës ka vendosur t'i ndajë FHK-së 300 mijë euro. "65-vjetori i Federatës së Hendbollit të Kosovës edhe për mua është shumë domethënëse. Me rregulloren e re të katego-

rizimit, në 2019-n buxheti do të shkojë deri në 300 mijë euro që Qeveria ia ka ndarë Federatës së Hendbollit të Kosovës, buxhet ky që në vitin 2018 ka qenë 230 mijë euro", ka deklaruar ai. Kryeministri foli edhe për Ligjin për sponsorizime, duke bërë me dije se, pavarësisht prej vështirë-

sive, ky ligj do të inkorporohet në ligjin e ri për tatimin mbi korporatat dhe do t'i mundësojë të hyra substanciale sportit në përgjithësi.

Ndërsa kryetari i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, foli për gjeneratat e shumta që kontribuuan në këtë sport për 65 vjet. "Gjenerata dhe individë të shumtë defiluan dhe u angazhuan gjatë 65 vjetëve të kaluara dhe se munda, dashuria dhe sakrificat e tyre për sportin më atraktiv bënë që ne sot të jemi krenarë dhe të nderuar me arritjet që janë bërë nga mijëra individë gjatë këtyre dekadave të kaluara", ka deklaruar Saraçini.

I pranishëm në ceremoninë festive të Federatës së Hendbollit të Kosovës ishte edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi. Ky i fundit e vlerësoi vitin 2018 jashtëzakonisht të mirë për sportin Kosovës.

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 20 DEJTOR - Federata e Hendbollit e Kosovës (FHK) të enjten ka shënuar 65-vjetorin e themelimit. I pranishëm në këtë ceremoni festive ishte edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Shefi i ekzekutivit ka thënë nuk është e lehtë që në Kosovë të jesh sportist, por është shprehur i bindur se hendbolli i Kosovës do

t'i prekë majat botërore në këtë sport. "Nuk është lehtë të jesh sportist në Kosovë, një vend që është i ri, me sfida. Disa nga sportistët tanë kanë prekur majat botërore, disa të tjerë janë ende të sfiduar për t'i arritur ato maja, por i uroj hendbollit kosovar, Federatës së Hendbollit të Kosovës për suksese, që jo vetëm se do të mburremi në rajon e më gjerë, por edhe t'i arrijmë majat e hendbollit botëror", ka thënë Haradinaj.

Zeneli, futbollisti i vitit në Kosovë

Anëtari i ekipit holandez Heerenveen, Arbër Zeneli, është shpallur lojtari i vitit në Kosovë. Ndërsa lojtari më i mirë i Superligës është shpallur Xhevdet Shabani i Dritës

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në futboll dhe anëtari i skuadrës holandeze Heerenveen, Arbër Zeneli, është shpallur lojtari më i mirë i vitit 2018 në Kosovë. Kjo është bërë me dije të enjten në mbremjen gala të shpalljes së laureatëve të vitit 2018 nga Federata e Futbollit të Kosovës. Zeneli me depërtime, asistime dhe me golat e tij ishte lojtari kyç në suksesin historik të "Dardanëve" në Ligën e Kombeve, kurse ai është bërë edhe lojtari i parë i Kosovës që shënon tre gola në një ndeshje. Zeneli në fanellën e "Dardanëve" është

paraqitur pesëmbëdhjetë herë dhe ka shënuar gjashtë gola. Ndërsa ylli i skuadrës së Dritës, Xhevdet Shabani, e ka fituar çmimin e futbollit të vitit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Shabani ishte më meritor për suksesin e skuadrës nga Gjilani në rrugëtimin drejt titullit kampion në elitë, por edhe në finale të Superkupës ndaj Prishtinës. Anëtori pati paraqitje të mira edhe në arenën ndërkombëtare. Ndërsa çmimi i golashënuesit më të mirë është ndarë nga Betim Haxhimusa, Alban Shillova dhe Kastriot Rexha, me nga 13 gola. Bekim Isufi është

shpallur trajneri më i mirë për vitin 2018 në futbollin e Kosovës. Strategu gjilanas i priu Dritës drejt suksesit në garën për titull të kampionit, kurse me sukses e drejtoi edhe në garat ndërkombëtare: Ligën e Kampionëve dhe Evropë Ligë. Isufi e fitoi me Dritën edhe Superkupën e Kosovës, pasi në finale e mposhti Prishtinën. Aktualisht trajneri Isufi është i papunë. Federata e Futbollit të Kosovës e ka nderuar me mirënjohje edhe trajnerin e Përfaqësueses, Bernard Challandes, pas suksesit historik që e arriti në Ligën e Kombeve.

**FORMACIONI I VITIT NË SUPERLIGË**

Visar Bekaj, Armened Thaqi, Armend Dallku, Leotrim Bekteshi, Yll Hoxha, Hamdi Namani, Endrit Krasniqi, Xhevdet Shabani, Mendurim Hoti, Festim Alidema dhe Kastriot Rexha.

Kosova, ngritjen më të madhe në renditjen e FIFA-s



Përfaqësuesja e Kosovës në futboll, pas suksesit historik në Ligën e Kombeve, ka pësuar rritjen më të madhe në renditjen e FIFA-s në vitin 2018. "Dardanët" janë ngritur për 46 pozita dhe tash renditen në vendin e 131-të

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka arritur të jetë skuadra me ngritjen më të madhe këtë vit. "Dardanët" ndodhen në vendin e 131-të të renditjes, duke u ngjitur me plot 46 vende nga viti i kaluar. Kosova nuk ka pësuar humbje që nga 13 nëntori i vitit 2017, kur Kosova nisi serinë pozitive me fitoren 4-3 kundër Letonisë në miqë-

soren e zhvilluar në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë, ndeshje në të cilën kombëtarin e kishte drejtuar Muharrem Sahiti. Ndërkohë, nga marsi i këtij viti drejtimin e ekipit e ka marrë Bernard Challandes, nën drejtimin e të cilit Kosova ka regjistruar shtatë fitore dhe dy barazime. Ndërsa Kombëtarja e Shqipërisë e ka mbyllur këtë vit në

vendin e 60 të renditjes me 1372 pikë. Belgjika ka arritur të shpallet skuadra e vitit në renditjen e FIFA-s, megjithëse Botërorin e Rusisë e fitoi Franca. Me një pikë më shumë kryesojnë belgët ndaj francezëve duke ruajtur pozicionin në krye. Top dhjetëshen e kompletojnë Brazili, Kroacia, Anglia, Portugalia, Uruguai, Zvicra, Spanja dhe Danimarka.

Sot përfundon sezoni vjeshtor në Media Ligë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Sot (e premte) me ndeshjet e javës së 15-të përfundon sezoni vjeshtor në Media Ligë. Pavarësisht se është edhe një xhiro për t'u zhvilluar, "Epoka e re" është

kampione vjeshtore. Kundërshtar i radhës i ekipit lider është ekipi i "Telegrafit", që renditet në mesin e tabelës. Rivali kryesor i "Epokës së re", "Media Works", këtë xhiro ka

punë të lehtë për faktin se luan ndaj ekipit të fundit në tabelë "D+". Dy nga ndeshjet me interesante për këtë javë janë "Gazeta Metro"- "Infokusi" dhe "KosovaPress"- "Gazeta Zëri".

Në ndeshjet e tjera takohen: "Lajmi.net"- "InfoKosova & PrishtinaPost", "RTK"- "RTV Dukagjini", "Klan Kosova"- "Ora Info", "Kallxo.com"- "Gazeta Blic".



Musa, sportisti i vitit nga Federata e Bodybuildingut dhe Fitnesit

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Federata e Bodybuildingut dhe Fitnesit në Kosovë ka mbajtur ceremoninë e fundvitit gjatë së cilës ka shpallur laureatët e vitit 2018. Sportisti më i mirë në kategorinë e Forcës për vitin 2018 u zgjodh Besmir Musa, në ngritjen e peshave deri në 490 kilogramë. Epitetin e klubit më të mirë për këtë vit e mori klubi "Five Star" në Prishtinë, ndërsa gjyqtari i vitit për këtë lloj të sportit u shpall Xhevdet Lebaja, raporton "kp". Me epitetin kampionë e sportistë më të mirë në kategori të ndryshme u nderuan edhe Shend Krasniqi, Mensur Zeqiri, Valdete Tahiri, Blerta Ibrahim, Nikollë Hajdaraj, Bylent Kera, Besart Salihu, Asaf Llozhani etj. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se ky lloj sporti është i rëndësishëm dhe premtoi përkrahje për këtë federatë edhe për vitin 2019. "Është një prej viteve që po kullon me rezultate në të gjitha llojet e sportit, dhe në kuadër të kësaj jam shumë i bindur që edhe sporti i kësaj federate ka pasur rezultate të mira, ka pasur suksese të mira. Natyrisht që është sport pak më



specifik, dhe natyrshëm mund të mos jenë parë rezultatet dhe sukseset e sportistëve të bodybuildingut dhe fitnesit, por gjithsesi është pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të sporteve në Kosovë", ka thënë Gashi.

Kryetari i FBFK-së, Esat Lata, vitin 2018 për këtë federatë e ka cilësuar shumë të suksesshëm, e për vitin 2019 premtoi më shumë punë e medalje të reja për Kosovën në sportin e bodybuildingut. "Këtë vit kemi bërë një punë të jashtëzakonshme duke përfaqësuar vendin tonë edhe në gara ndërkombëtare me pozicione goxha të mira, jo sikur vitin e kaluar, po sigurisht se

edhe vjet kemi vende të suksesshme, ku kemi përfaqësuar të mirë në kampionatet e Evropës, në të cilën i kemi dy vende, Besart Maxharri ka qenë në vendin e katërt në Evropë, kurse në vendin e pestë Edona Luta", ka thënë Lata. Gjatë ceremonisë u ndanë edhe mirënjohje të veçanta për MKRS-në, Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Drejtorinë e Sportit, si institucione që e përkrahën këtë federatë. Ndërsa Flamur Rexhaj, Astrit Bytyqi dhe Shpejtim Buduri u nderuan me mirënjohje të veçanta si individë. Epitetin punëtori sportiv i vitit 2018 e mori Mirsad Bojku.

Kampionët e Golden States pësojnë humbje në 'Salt Lake City'

OAKLAND, 20 DHJETOR - Viojnë ulje-ngritjet e Golden State Warriorsit në këtë sezon. Kampionët në fuqi të NBA-së nuk po kalojnë një moment të mirë, pasi pësuan humbjen e 11-të në 32 takime, shumë për një skuadër që është mësuar duke vendosur rekorde të njëpasnjëshme. Në "Salt Lake City", Golden State u dorëzua me shifrat 108-103 përballë vendësve të Utah Jazzit. Curry dhe Durant ishin dy basketbollistët më të mirë në parket respektivisht me 32 dhe 30 pikë, por diferencën në këtë ndeshje e bëri loja në grup e Utahit me plot gjashtë lojtarë të vendësve që arritën një kuotë pikësh me dy shifra, raporton "SS". Mori fitoren e tretë radhazi Oklahoma City Thunder, sukses që e ngjiti skuadrën e trajnerit Billy Donovan në vendin e dytë të konferencës së Perëndimit me një bilanc prej 20 fitoresh dhe 10 humbjesh. Në transfertën kaliforniane ndaj Sacramento King heroit i padiskutueshëm i City Thunderit ishte Paul George i cili bëri një paraqitje të shkëlqyer duke koleksionuar 43 pikë, 7 asistime dhe 12



rebounde në suksesin 132-113 të Oklahomës. Fantastik edhe Rusell Westbrook me një tripe-double, me yllin e City Thunderit që regjistroi 19 pikë, 17 asistime dhe 11 rikuperime poshtë tabelës. Një fitore me shumë peshë mori edhe Portland Trail Blazers. Skuadra nga Oregoni mposhti në shtëpi 99-92 Memphis Grizzlies, për meritë edhe të Damian Lillard, autor i 24 pikëve. Falë James Hardenit arriti të buzëqeshte edhe Houston Rocketsi

që në Toyota Center kaloi me shifrat e thella 136-118 kryeqytetasit e Washington Wizardsit. 35 pikë realizoi i përhershmi James Harden në këtë sfidë, ndërsa miqve nuk u mjaftuan 28 pikët e Bradley Bealit. U rikthye te suksesi pas dy humbjeve radhazi Toronto Raptorsi, që në shtëpi tregoi dhëmbët ndaj Indiana Pacersit, duke fituar 99-96 në një ndeshje ku diferencën e bëri Kawhi Leonard me 28 pikë, 6 asistime dhe 10 rebounde.

SHKURT

Shaqiri: Babai e ka ndihmuar familjen në Kosovë

Futbollisti shqiptar i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, ishte i ftuar në rubrikën "What's In a Photo" dhe përmes fotografive ka folur për të kaluarën e vet dhe për vështirësitë e familjes në Kosovë. Derisa shihet fotografinë e familjes, Shaqiri ka thënë se familja është gjëja më e rëndësishme në botë për të. "Prindërit kanë punuar shumë. Babai ishte punëtor rrugësh. Ka punuar shumë për familjen. Është përkujdesur edhe për familjen tonë në Kosovë që ishte shumë e varfër. Prandaj jam shumë krenar", ka thënë Shaqiri.

Schumacheri ishte i vetëdijshëm gjatë transferimit në spital

Gjatë transferimit me ambulancë nga spitali i Grenoblës në qendrën e rehabilitimit të Spitalit Universitar të Lozanës, ish-kampioni legjendar i Formulës 1, Michael Schumacher, ishte i vetëdijshëm. "Ai pothuajse gjithmonë i mbajti sytë hapur, nuk fliste, por komunikoi me lëvizje të lehta", shkruan gazeta zvicerane "Blick". Personeli i transferimit duhej t'i dorëzonte telefonat celularë për ta siguruar privatësinë maksimale. Sipas gazetës, Schumi dukej se kishte humbur peshë. Michael Schumacher po luftonte me vdekjen që prej aksidentit të 29 dhjetorit të 2013-s, kur u përfshi në një përplasje me ski.

Mourinho: Ka jetë edhe pa Unitedin

Trajneri Jose Mourinho nuk ka dashur të flasë shumë rreth mënyrës se si u shkarkua nga Manchester Unitedi. Portugezi ka thënë se Manchester Unitedi ka një të ardhme pa të, por edhe ai një të ardhme pa Unitedin. "Ajo që bëra kur lash Chelsea për shembull, është e njëjta gjë që do të bëj edhe tani. Mbaj vetëm gjërat pozitive dhe nuk flas për diçka që ka ndodhur në klub. Mund të flasim për shumë gjëra, mund të flasim për gjërat negative, por ky nuk jam unë. Tani mbaroi dhe Manchester United ka një të ardhme pa mua dhe unë kam një të ardhme pa Unitedin. Pse duhet të flas më shumë tani? Edhe në lidhje me tifozët apo ndjenjat e mia. Mori fund. Kështu kam qenë gjithnjë unë. I kam kritikuar gjithnjë trajnerët që largohen nga klubet dhe flasin për detajet se çfarë ka ndodhur apo kush e ka fajin. Por ky nuk jam unë. Unë thjesht dua që të mbyllet ashtu siç ndodhi dhe më pëlqen të them se loja përfundoi", ka thënë Mourinho. "Shpresoj që mediet ta respektojnë këtë mënyrë se si jam gatuar unë. Derisa të rikthehem në futboll mendoj se kam të drejtën të jetoj jetën time, ashtu siç jam duke e bërë tani. Kjo është gjithçka dua të bëj. Manchester United është e shkuara", ka deklaruar Mourinho.

Veteli: Federeri është shembull i një sportisti

Ish-kampioni i botës në Formula 1, Sebastian Vettel, adhuron edhe dy sporte, tenis dhe futbollin. Piloti i Ferrarit, i cili përfundoi i dyti këtë herë në kampionatin e veturave të shpejta me 320 pikë, ka bërë me dije se ishte kryesisht tifoz i tenistit, Roger Federer. "Kam pasur mundësi të takohen vetëm një herë. Shtrënguam duart dhe kjo është e gjitha. Unë kurrë nuk kisha mundësi që të bisedoja me të. Ai është simbol i estetikës dhe përsosmëri në sport. Federeri është i përjetshëm. Ka rregulla që vlejné për të gjithë ose është një përvojë e jashtëzakonshme, është 37-vjeçar", ka thënë Vettel. Përveç që ndjek turnetë e tenisit nëpër botë, Veteli është një tifoz i pasionuar i ekipit të futbollit, Eintracht Frankfurt. "Unë jam një tifoz i madh i Eintrachtut. Këtë sezon jemi duke u bërë të mëdhenj. Ka shumë që besojnë se Frankforti do të përfundojë në zonën e Ligës së Kampionëve. Ne do të shohim se çfarë do të ndodhë", ka deklaruar Veteli.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave –Ministarstvo za Finansije- Ministry of Finance
Agjencioni Qendror i Prokurimit /Centralna/Agencia/
Nabavke/Central/Prokurment/Agency

Oslanjajući se na Zakon br.03/L149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo i Pravilnik br.02/2010 o Postupcima Rekrutacije u Civilnoj Službi,Centralna Agencija za Nabavke objavljuje:

Konkurs za slobodno radno mesto

Naziv radnog mesta: Pravni Službenik2
Koeficijent: Sedam (7)
Referentni broj radnog mesta : 10/18
Izveštava: Generalnom Direktor Centralne Agencije za Nabavku
Puno radno vreme: Da
Mesto: Priština

Svrha radnog mesta: Pružanje usluga i profesionalnih saveta u oblasti izrade politika i zakonodavstva iz delokruga institucije.

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Generalnog Direktora izvršava zadatke i odgovornosti kao u nastavku:

1. Izrađuje normativne akte, kao i druge pravne akte koji proizilaze iz delokruga institucije na osnovu procedura koje su određene važećim zakonima #15
2. Vodi računa za usklađivanje nacrt-zakona i ostalih podzakonskih akata sa Ustavom Kosova i važećim zakonima na Kosovu #15
3. Vodi računa da sadržaj i forma normativnog akta bude precizna sa jezičkog i tehničkog aspekta, kao i da isti budu identični na sva tri službena jezika #15
4. Vršiti istraživanja i analize informacija na temama koja se određuju od strane nadzornika i identifikuje opcije i pitanja za razmatranje
5. Bazirajući se na zahtev i uputstvo višeg nivoa daje mišljenja, kao i vrši izradu nacrt-ugovora, nacrt-odluka i ostalih nacrt-akata #10
6. Sarađuje i komunicira sa ostalim jedinicama unutar i van institucije o aktivnostima koje se nadovezuju o blasti zakonodavstva #20
7. Izvršava i ostale zadatke u skladu sa ciljem radnog mesta koje se mogu zahtevati povremeno od strane nadzornika #5

Kvalifikacije,radno iskustvo i sposobnosti:

1. Odlična znanja o specifičnoj profesionalnoj oblasti koja se dobijaju putem univerzitetskog obrazovanja i relevantnog treninga
2. Poznavanje važećih zakona i uredbi
3. Sposobnosti komuniciranja, planiranja rada i eventualnog koordinisanja osoblja na administrativnom nivou
4. Istraživačke sposobnosti, analitičke sposobnosti i sposobnosti formulisanja preporuka i profesionalnih saveta
5. Sposobnosti rada na kompjuterskim aplikacijama i programima (Word, Excel, Power Point, Access)
6. Univerzitetska diploma, Univerzitetska diploma (Pravni Fakultet)
7. Najmanje 2 godine radnog iskustva

OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE U VEZI SA POSTUPCIMA KONKURISANJA

Civilna Služba Kosova služi svim stanovnicima i pozdravlja prijavljivanje žena i muškaraca svih zajednica na Kosovu.

Nevećinska zajednica i njihovi članovi imaju pravo na pravilnu i proporcionalnu zastupljenost u organima Civilne Službe, kako je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo.

Uz aplikaciju treba predati :

Overenu kopiju diplome;
Dokaze o radnom odnosu (ili dokaze iz Penzijskog Fonda);
Potvrdu da nije pod istragom
Kopiju lične karte.

Kandidati koji će biti u užoj listi će biti informisani pismeno ili telefonom u zakonskom roku.

Aplikacije možete uzeti i predati u Centralnoj Agenciji za Nabavke,zgrada bivše Grmije,V sprat,kancelarija personala A/501 kao i na broj telefona: 038/213/650,centrix:200/15/511 od 08:00 do 16:00 časova.

- Zahtevi koji stignu nakon određenog roka se neće prihvatiti ,nekompletirani dokumenti će se odbiti.

- U slučaju prijavljivanja velikog broja kandidata,samo kandidati iz uže liste će biti kontaktirani.Kandidati koji će biti pozvani na intervju treba da donesu originalna dokumenta radi verifikacije.

Rok za konkurisanje je od dana: 21.12.2018

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave –Ministarstvo za Finansije- Ministry of Finance
Agjencioni Qendror i Prokurimit /Centralna/Agencia/
Nabavke/Central/Prokurment/Agency

KONKURS

Duke u bazuar në Ligjin nr.03/L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencioni Qendror i Prokurimit, shpall konkurs për këtë vend pune:

1.Titulli i postit :Zyrtar Ligjor 2.
Koeficienti: Shtatë (7)
Numri i Referencës së vendit të punës:10/18
I Raporton: Drejtorit të Përgjithshëm të AQP-së
Orar i Plotë i punës: Po
Vendi: Prishtine.

Qëllimet e Vendit të Punës: Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave profesionale në fushën e hartimit të politikave dhe legjislacionit nga fushëveprimi i institucionit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë :

Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi; 15%

2. Siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë; 15%

3. Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare; 15%

4. Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim

5. Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera; 10%

6. Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjislacionit; 20%

7. Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

Kualifikimet, Përvoja e punës dhe aftësitë:

- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Diplomë universitare (Fakulteti Juridik) minimum 2 vite përvojë pune profesionale.

INFORMATE E PERGJITHESHME PER KANDIDATET LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Komuniteti jo shumice dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil, siç e specifikon Neni 11,paragrafi 3,i Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentacioni i kërkuar për aplikim:

Kopje e vërtetuar e diplomës;
Vërtetim mbi përvojën e punës ose(dëshmi nga trusti pensional)
Vërtetim që nuk është nën hetime;
Kopja e letërnjoftimit.

Kandidatët që hynë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë, do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në AQP, ndërtesa e ish Gërmisë, kati V zyra e personelit A/501.si dhe në nr. tel:038/213/650,centrix:200/15/511 prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet të sjellin për verifikim dokumentet origjinal.

Afati i konkurimit është prej datës:21.12.2018

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333**



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi. Çmimi sipas marrëveshjes.

Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Dije Rashiti shpallë të pavlefshme diplomën SHMM " Luciano Motroni " Prizren.
- ▶ Alen Gorani shpallë të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Ekrem Rexha Drini" Lubizhd.
- ▶ Jasmin Gorani shpallë të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Ekrem Rexha Drini" Lubizhd.
- ▶ Nerges Tahiri shpallë të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Zepe Sopaj shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Admir Bajrami shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Nurtene Metëhiu shpallë të pavlefshëm ID kartelën e fakultetit të edukimit në drejtimin parashkollor Prishtinë
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m². Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjëm me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajazitit". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshohet me qira banesën e mobiluar te saloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshohet banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshohet banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmë, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

FITO 2 SUPER muaj FALAS me SuperDUO!

Abonohu në ndonjërin nga pakot **SuperDUO** dhe paguaj vetëm 10 muaj, ndërsa 2 të fundit merri **FALAS**. Përveç kësaj, fiton edhe **3 SIM kartela me 3 muaj komunikim FALAS** brenda rrjetit të IPKO-së. Pagesa mund të bëhet në baza mujore.

Pakot e **SuperDUO** janë pakot më të kompletuara në treg. Ato ofrojnë internet mbi **50Mbps** dhe përmbajtje mbi **150 kanale televizive** me të gjitha ligat më emocionuese të futbollit (Premier League, Serie A, La Liga), si dhe kanalet sportive më të popullarizuara botërore.

ÇKA O' SUPER O' SUPER!

Merr ofertën në dyqanin më të afërt të IPKO-së.

*Nxito, oferta është promovionale.

WWW.IPKO.COM

